



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 18 regjistër (JR)
Datë 09.05.2023

Nr. 62 i vendimit
Datë 23.07.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|------------------------|------------------|
| Albana Shtylla | Kryesuese |
| Sokol Çomo | Relator |
| Natasha Mulaj | Anëtare |
| Ina Rama | Anëtare |
| Rezarta Schuetz | Anëtare |

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 23.07.2025, ora 11:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 18/2023 (JR), datë 09.05.2023, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Hysen Ajasllari, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 630, datë 03.03.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllari.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; Kodi i Procedurës Civile; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllari, të paraqitura në ankim, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 630, datë 03.03.2023, dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Hysen Ajasllari, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht, deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³ dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar⁵, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive.*
 - (iii) *Ka mosdeklarime të pasurive.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 25.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklarama e pasurisë në rubrikën përkatëse.

³ Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 25.01.2017.

⁴ Dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme më datë 25.01.2017, sipas referimit në raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllari.

⁵ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 12.12.2019.

nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Hysen P. Ajasllari për vazhdimin e detyrës.

5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm⁶ për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Hysen Ajasllari, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 630, datë 03.03.2023, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllari, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, trupi gjykues, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e subjektit dhe analizoi provat e paraqitura në mbështetje të shpjegimeve të tij, çmon se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës në lidhje me krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve me burime të ligjshme të ardhurash në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën (-) 5.320.076 lekë, sipas nenit 33, pika 5, germa “b”. Subjekti ka kryer deklarime jo në përputhje me ligjin, deklarime të rreme, si dhe ka ndërmarrë veprime të cilat rezultuan se nuk i përshtaten aspak figurës së një magjistrati, duke sjellë për pasojë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, shkaqe këto të cilat justifikojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pikat 3 dhe 5, si dhe nenit 33, pika 5, gërmat “a”, “b” dhe “ç”.

8.2. Në lidhje me kontrollin e figurës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit të dhënat e kërkuara në deklaratën e kontrollit të figurës. Nga hetimi administrativ i kryer, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Hysen Ajasllari ka

⁶ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 31.03.2022.

arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

8.3. *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm, nuk janë konstatuar shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore dhe serioze në lidhje me drejtimin e hetimeve apo vendimmarrjen nga ana e tij, shkaqe këto që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se, bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Hysen Ajasllari ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 630, datë 03.03.2023, duke e kundërshtuar atë si vendim të padrejtë, të pambështetur në ligj dhe në prova. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi objekt ankimi është marrë në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të përcaktuara në nenin 6 të KEDNj-së dhe në nenin 42 të Kushtetutës; në interpretim të gabuar të provave të administruara gjatë hetimit administrativ; nuk është arsyetuar plotësisht, si dhe është rezultat i vlerësimit të gabuar të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
10. Subjekti i rivlerësimit, ankimin e tij e shoqëroi me disa akte shkresore në cilësinë e provave të reja në proces. Bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjykimit, të vendosë:
 - *Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.*
 - *Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja ndaj subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllari, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.*
 - *Çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja [...].*
 - *Ndryshimin e vendimit nr. 630, datë 03.03.2023, të Komisioni të Pavarur të Kualifikimit duke vendosur konfirmimin në detyrë të ankuesit.*
11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 11.1. *Subjektit të rivlerësimit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj.*

11.2. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se është shkelur neni 7 i KEDNj-së për shkak se, sipas tij, është cenuar parimi i sigurisë juridike.*

11.3. *Vendimi i Komisionit është rrjedhojë e një procesi të zhvilluar në shkelje të rënda të dispozitave procedurale.*

12. *Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.*

12.1. *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, është i pambështetur në provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe në parashikimet ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar.*

12.2. *Konkluzioni i Komisionit lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “shtëpi banimi”, me sipërfaqe të katit përdhes 99,6 m² dhe sipërfaqe të katit të parë 120,6 m², si dhe truall prej 200 m², me vendndodhje në lagjen “{***}” Fier, është i gabuar dhe i pabazuar në fakte.*

12.3. *Konkluzioni i Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë së paluajtshme të llojit “njësi tregtare”, me sipërfaqe 44,2 m², me vendndodhje në Yzberisht, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për pagesën e çmimit të blerjes së dyqanit, është i pabazuar dhe, nga analiza e burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie, ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive.*

12.4. *Konkluzioni i Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë së luajtshme të llojit automjet, të tipit “Daimler Chrysler 203”, me targë {***}, si dhe analiza financiare e kryer për verifikimin e burimeve të ligjshme të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, janë të pabazuara. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të kryer për blerjen e automjetit objekt kontrolli, ka gabuar në përcaktimin e shumës së të ardhurave nga shitja e një tjetër automjeti në pronësi të subjektit në vitin 2009, të cilat janë përdorur për blerjen e tij.*

12.5. *Konkluzioni i Komisionit lidhur me krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit automjet të tipit “Benz Mercedes”, me targë {***}, në pronësi të personit të lidhur (djali i subjektit të rivlerësimit) F. A. është i gabuar dhe trajtimi nga Komisioni si person i lidhur i djalit të subjektit, i cili është ndarë nga trangu familjar në vitin 2013, bie ndesh me parashikimet ligjore të zbatueshme.*

12.6. *Konkluzioni i Komisionit lidhur me të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë së luajtshme të llojit automjet, të tipit “Benz Mercedes”, me targë {***}, të blerë në vitin 2014 nga personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit) dhe e shitur në vijim në të njëjtin vit, është i pabazuar pasi, lidhur me këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrime tatimore për shkak se këto të ardhura nuk përfshihen në gamën e të ardhurave të tatueshme.*

12.7. *Konkluzioni i Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë së luajtshme të llojit automjet të tipit “Volkswagen”, të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2000 dhe të shitur prej tij në vitin 2004, si pasojë e pasaktësisë në deklarimin vjetor lidhur me vlerën e kësaj pasurie, është një konkluzion i pambështetur në jurisprudencën e Kolegjit.*

12.8. Lidhur me dhurimin e deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting dhe atë periodike të vitit 2016, nga djali i subjektit të rivlerësimit E. A., në shumën 3.000 euro, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë dhurim dhe pretendoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive, sipas parashikimeve të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për të vërtetuar burimin e ligjshëm të parave të dërguara nga znj. I. E. për shkak të rrethanave specifike të rastit.

12.9. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar rezultatin e analizës financiare për periudhën e vlerësimit 1994-2003 dhe 2004-2016, si pasojë e përllogaritjes në mënyrë të gabuar të disa prej zërave të kësaj analize.

12.10. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me kualifikimin sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke pretenduar se aplikimi i këtij neni, si shkak për shkarkimin nga detyra, duhet të jetë rrjedhojë e një vlerësimi lidhur me gjetje të mangësive në të tria kriteret dhe jo vetëm në kriterin e pasurisë, dhe për shkaqe e shkëlqe që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara prej nenit 61, pikat 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin kalimtar të subjektit Hysen Ajasllari, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

14. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁷ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

⁷ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 630, datë 03.03.2023, për rivlerësimin e subjektit Hysen Ajasllari, i është njoftuar këtij të fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 11.04.2023, konfirmuar marrja dijeni më datë 12.04.2023, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision më datë 20.04.2023, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

15. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 630, datë 03.03.2023, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
16. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për marrjen e provave të reja, referuar këtu akteve shkresore që subjekti i kishte bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues, pasi i mori ato në shqyrtim, vlerësoi se, sa u takon akteve shkresore të depozituara nga subjekti në Kolegji, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

16.1. Kolegji vëren se shkresa e Avokatit të Popullit⁸, nëpërmjet së cilës subjekti pretendon se mbështet argumentet për cenimin e parimit të gjykimin nga një gjykatë e paanshme dhe e krijuar me ligj, në drejtim të provimit të faktit se anëtarët e trupit gjykues të Komisionit të cilët kanë shqyrtuar çështjen e tij nuk plotësojnë kriteret e zgjedhshmërisë për të qenë komisionerë, daton në vitin 2017, rreth 6 vite përpara vendimit objekt ankimi. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se në Komision, nuk rezulton të jenë ngritur pretendime në drejtim të përjashtimit të ndonjë prej anëtarëve të trupës gjykuese, në kontekst të mosplotësimit të kriterëve të zgjedhshmërisë, qoftë edhe në këndvështrimin e garancive për një trupë gjykuese të paanshme apo të gjykimin nga një gjykatë e krijuar me ligj, në kuptim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016. Nisur nga ky fakt, si dhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, ku nuk paraqitet asnjë parashtrim konkret mbi pengesat e subjektit të rivlerësimit për paraqitjen e kësaj shkrese gjatë hetimit administrativ, në kuadër të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara shprehimisht në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues arriti në përfundimin se akti objekt shqyrtimi nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë si provë e re në proces, në kuptim të kërkesave të dispozitës së sipërcituar dhe, për rrjedhojë, kërkesa për pranimin e këtij akti si provë e re në proces, nuk u pranua.

*Komisionit, nr. {***}, datë 20.04.2023, që rezulton të jetë dita e 8 nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit.*

⁸ *Shkresa e Avokatit të Popullit nr. {***} prot., datë 17.07.2020, me lëndë “Kthim përgjigjeje për verifikimin e procedurës dhe dokumentacionit përkatës të anëtarëve të zgjedhur në organet e rivlerësimit”.*

16.2. Lidhur me aktet e dorëzuara nga subjekti: (i) “Deklaratë noteriale” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2023, e z. Hysen Ajasllari; dhe (ii) formular aplikimi në ZVRPP Fier, me nr. {***}, datë 23.03.2023, shoqëruar me mandatin postar dhe një mandat arkëtimi mbi pagesat e kryera pranë ZVRPP-së Fier, për çregjistrimin nga emri i tij të pasurisë së paluajtshme të llojit “truall” me sipërfaqe 35 m², me anë të cilave subjekti kërkoi të provonte faktin mbi marrjen e masave të menjëhershme për çregjistrimin e kësaj pasurie, e cila figuronte në emër të tij, trupi gjykues vëren se këtë aplikim, subjekti i rivlerësimit e ka kryer pas dhënies së vendimit të Komisionit dhe në vijim të përgjigjes së marrë lidhur me kërkesën e datës 16.02.2023 pranë AShK Fier, për sqarimin e situatës lidhur me regjistrimin e pasurisë nr. {***}, truall me sipërfaqe 35 m², në emrin e tij. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se lidhur me këto akte shkresore, plotësohen kriteret për pranueshmërinë e tyre si prova të reja, të përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, duke qenë se subjekti duket të ketë marrë dijeni të faktit të regjistrimit të kësaj pasurie në emër të tij në janar të vitit 2023, me dërgimin e pyetësorit nr. 2 të Komisionit dhe vetëm në datën 21 shkurt të vitit 2023, ka marrë përgjigje lidhur me sqarimin e situatës së këtij regjistrimi nga AShK Fier, ndërkohë që vendimi i Komisionit është dhënë në datën 03.03.2023. Megjithatë, në kuadër të vlerësimit të nevojës për administrimin e këtyre provave, nga shqyrtimi i shkakut të ankimit lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie, trupi gjykues arriti në përfundimin se aktet e mësipërme provojnë një fakt, i cili, në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, është i parëndësishëm për vendimmarrjen.

17. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit të fashikullit të administruar gjatë procesit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm, dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së kryer lidhur me kërkesat e subjektit për marrjen e provave të reja, në kuadër të kërkimit të tij në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

18. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjykimin nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se:*

18.1. Komisioni nuk përmbush standardin e vendosur nga GjEDNj-ja, në drejtim të plotësisimit të 4 kritereve që përcaktojnë nëse një organ që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve përbën një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, më konkretisht sa i takon:

(i) *Përfaqësimi thelbësor të komunitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përbërjen e organit disiplinor.* Referuar këtij kriteri, sipas subjektit të rivlerësimit, rezultoi që asnjë prej 12 komisionerëve të Komisionit nuk vjen nga radhët e sistemit gjyqësor në momentin e caktimit në detyrë.

(ii) *Procedurës së caktimit të anëtarëve të organit disiplinor, dhënies së garancive ndaj presioneve të jashtme.* Lidhur me këtë kriter, subjekti pretendoi se të 12 komisionerët e Komisionit janë zgjedhur nga një komitet parlamentar specifik *ad hoc* dhe janë caktuar nga Parlamenti pa përfshirjen e trupës gjyqësore. Sipas subjektit të rivlerësimit, formimi i Komisionit dhe, për rrjedhojë, edhe i trupës gjyqësore që ka shqyrtuar çështjen e tij, bie ndesh me vendimin e GjEDNj-së të datës 12 mars 2019, lidhur me çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës*, ku sipas subjektit, GjEDNj-ja ka vendosur se shkelja e kritereve ligjore për emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Apelit përbën shkelje të garancisë së nenit 6/1 të KEDNj-së për t'u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, e pavarur dhe e paanshme. Anëtarët që kanë shqyrtuar çështjen ndaj ankuesit nuk kanë përmbushur, sipas këtij të fundit, kërkesat e përzgjedhjes, të përcaktuara me ligjin nr. 84/2016. Ky ligj, sipas subjektit, përcakton kritere strikte, por nuk parashikon se si do të verifikohen kushtet e zgjedhshmërisë së kandidatëve nga Presidenti, Avokati i Popullit apo ONM-ja. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se tre anëtarët e Komisionit që kanë shqyrtuar çështjen e tij, nuk plotësojnë të kriteret ligjore për të qenë komisionerë, duke u renditur nga Avokati i Popullit pikërisht në këtë listë. Në kuadër të të provuarit të këtij fakti, subjekti i rivlerësimit është shprehur në ankim se ka përcjellë në cilësinë e akteve provuese bashkëlidhur ankimit: (i) shkresën e Avokatit të Popullit nr. {***}, datë 17.07.2020, nëpërmjet së cilës Avokati i Popullit informon shoqatën “Drejtësi për Drejtësinë” për problemet e rënda që ka pasur procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit.

(iii) *Shmangies së mbivendosjes së funksioneve të ndryshme.* Subjekti pretendoi se është cenuar haptazi parimi i gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në kushtet kur i njëjti trup gjykues ka kryer hetimin e fakteve dhe ka dhënë vendim lidhur me gjetjet e bëra nga ai vetë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në rastin konkret, ka treguar anshmëri dhe paragjykim në mënyrë të hapur dhe, si rrjedhojë, nuk përmbush kriteret e nenit 6 të KEDNj-së për t'u konsideruar “gjykatë” e paanshme e caktuar me ligj.

19. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mungesa në përbërje të Komisionit e anëtarëve me prejardhje profesionale nga sistemi gjyqësor, si dhe problematikat e pretenduara në procedurën e caktimit të anëtarëve të organit disiplinor, të cilat ndikojnë në kriterin e dytë, atë të dhënies së garancive ndaj presioneve të jashtme të këtij organi, cenojnë paanësinë dhe pavarësinë e trupave gjyqësore të tij, referuar kritereve të përcaktuara

nga jurisprudenca e GjEDNj-së⁹ për një organ disiplinor, me efekt cenimin e nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues, në shqyrtimin e këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, referuar edhe qëndrimin të deritanishëm në vendimmarrje të mëparshme të tij, mban në konsideratë faktin që Komisioni është ngritur nga Kushtetuta si një organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të kryejë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas një procedure e cila garanton respektimin e parimeve të procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit¹⁰. Kriteret e zgjedhjes në detyrë të komisionerëve janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, ku, referuar parashikimeve të nenit 6, pika 1, germa “ë” e ligjit, bie në sy fakti se qenia gjyqtar apo prokuror gjatë dy viteve të fundit para kandidimit, përcaktohet si kriter përjashtues në vlerësimin e kandidaturave për t’u zgjedhur komisionerë. Për më tepër, vlen të theksohet fakti që ligji nr. 84/2016 i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë e tij nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka arritur në konkluzionin se *nuk ka konstatuar asnjë problematikë në drejtim të përbërjes së Komisionit, me efekt cenimin e parimit të pavarësisë dhe paanësisë*.

20. Duke përmbyllur analizën e mësipërme, trupi gjykues thekson se një pretendim i tillë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar edhe nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj lidhur me çështjen gjyqësore *Xhoxhaj k. Shqipërisë*, ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar, për rrjedhojë, shkelje të nenit 6 të KEDNj-së lidhur me sa më sipër.
21. Trupi gjykues vëren gjithashtu se cenimi i parimeve të procesit të rregullt adresohet nga subjekti i rivlerësimit edhe në drejtim të pretendimit se anëtarët e trupit gjykues që kanë shqyrtuar çështjen e tij në Komision, nuk plotësonin kriteret ligjore të parashikuara nga neni 6 i ligjit nr. 84/2016, për të qenë komisionerë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Trupi gjykues, në përputhje dhe me jurisprudencën e Kolegjit lidhur me kërkesa të ngjashme në çështje të mëparshme¹¹, çmoi se, për sa kohë pretendimi i ngritur lidhur me mospërbushjen e kriterëve ligjore për zgjedhshmërinë në detyrë të komisionerëve, nuk bën pjesë në kompetencën juridiksionale të Kolegjit dhe në kushtet kur nuk u pretenduan nga subjekti dhe as u konstatuan kryesisht nga Kolegji, fakte apo rrethana të tjera në drejtim të mosformimit të rregullt të trupit gjykues, që do ta bënin vendimmarrjen e Komisionit të cënueshme në drejtim të pavarësisë apo paanësisë së saj, vlerësuar kjo në kuadër të rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe jurisprudenca e GjEDNj-së, ky shkak ankimi gjendet i pabazuar. Në vijim të sa më sipër, edhe shkresa e Avokatit të Popullit nr. {***} prot., datë 17.07.2020, të cilën subjekti i rivlerësimit kërkoi të merret në cilësinë e provës së re në proces, përpos mosplotësimit të kriterëve formale të pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr.

⁹ Subjekti referon në ankim vendimin e GjEDNj-së për çështjen *Oleksandr Volkov v. Ukraine*.

¹⁰ Shih nenin 179/b, pikat 2, 5, 6, 8 dhe 10 të Kushtetutës.

¹¹ Shih vendimin e Kolegjit nr. 3 (JR), datë 06.02.2023; nr. 15 (JR), datë 15.04.2023; nr. 50 (JR), datë 21.11.2023 etj.

49/2012, u vlerësua nga trupi gjykues edhe si provë e panevojshme në kuptim të parashikimit të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

22. Sa i takon shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se mbivendosja në të njëjtin trup gjykues e funksioneve të hetimit administrativ në lidhje me kriteret e rivlerësimit, çmimit të provave dhe vendimmarrjes lidhur me rivlerësimin kalimtar të tij, nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, me pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues e vlerësoi këtë pretendim si të pabazuar në ligj. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim pasi çmoi se veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Trupi gjykues vëren se në të njëjtin konkluzion për moscenim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, ka arritur edhe GjEDNj-ja në çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të ngjashme të kërkuases lidhur me cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.
23. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se janë shkelur nenet 6 dhe 7 të KEDNj-së për shkak se, sipas tij, është cenuar parimi i sigurisë juridike.* Këtë shkak të ankimit, subjekti e mbështeti në pretendimet se: (i) rregullat e përcaktuara në procesin e rivlerësimit dhe sidomos në procesin e zhvilluar ndaj tij janë të padrejta dhe në shkelje të parimit të sigurisë juridike; (ii) Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për ngjarje dhe fakte të cilat datojnë gati 25 vite më parë; (iii) në vendimin e ankuesit është përdorur koncepti i “cenimit të besimit të publikut” në kundërshtim me parashikimet e Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së trupave të rivlerësimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky kriter për marrjen e masës disiplinore është vendosur në vlerësim tërësor të tri kriterëve të rivlerësimit dhe jo në vlerësim të konstatimeve të gjetura vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Për rrjedhojë, sipas subjektit, shkarkimi i tij është bazuar në terma të papërcaktuar as nga ligji dhe as nga trupa e Komisionit, duke rezultuar në interpretimin në mënyrë arbitrare të ligjit dhe në kundërshtim flagrant me legjislacionin e brendshëm; (iv) ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar masa të nevojshme procedurale për të parandaluar zbatimin arbitrar të ligjit përkatës material, duke cenuar në këtë mënyrë dukshëm parimin e sigurisë juridike; (v) Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim përse masa disiplinore për shkarkimin e subjektit duhet të bazohet në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe jo në nenin 61, pika 1 e të njëjtit ligj, sipas së cilit subjekti pretendon se nuk do të plotësoheshin kriteret e tij për shkarkim, duke qenë se pasuria e tij nuk arrin dyfishin e pasurisë së ligjshme.
24. Lidhur me këtë shkak të ankimit për cenim të parimit të sigurisë juridike dhe, rrjedhimisht, cenim të nenit 7 të KEDNj-së, i cili, referuar sa më sipër parashtruar, adresohet në drejtim të rregullave dhe procedurave të parashikuara nga ligji nr. 84/2016 për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, trupi gjykues vlerëson se ky shkak është i pabazuar në ligj, për sa kohë pretendime të njëjta janë ngritur edhe para Gjykatës Kushtetuese, e cila, pasi ka kryer kontrollin e kushtetutshmërisë së këtij ligji, me anë të vendimit të saj nr. 2, datë 18.01.2017, e ka gjetur atë në përputhje me Kushtetutën. Çdo pretendim konkret lidhur me interpretim të gabuar/arbitrar të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, është objekt i kontrollit nga ana e Kolegjit gjatë vlerësimit të

shkaqeve të ankimit lidhur me kriteret e rivlerësimit dhe qëndrimit të mbajtur nga Komisioni për çështjet objekt ankimi.

25. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi vendimin e Komisionit si rrjedhojë e një procesi të zhvilluar në shkelje të rënda të dispozitave procedurale. Subjekti i rivlerësimit e bazon këtë shkak në pretendimin se, lidhur me shkakun më të rëndë mbi të cilin është bazuar masa disiplinore e shkarkimit, ai është njohur vetëm kur i është njoftuar vendimi i arsyetuar¹².
26. Trupi gjykues vëren se ky pretendim është i paqartë për sa kohë nuk është konkretizuar se për cilën çështje konkrete pretendohet që Komisioni të mos i ketë kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues e mban në konsideratë këtë pretendim në shqyrtimin në vijim të shkaqeve të ankimit lidhur me vlerësimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit në kuadër të të cilave kryen edhe kontrollin e imtësishëm mbi momentin procedural të kalimit të barrës së provës, lidhur me gjetje/konkluzione të arritura nga Komisioni në vendim.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

27. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të gabuar dhe të pabazuar në fakte të konkluzionit të Komisionit për krijimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “shtëpi banimi” me sipërfaqe të katit përdhes 99,6 m² dhe sipërfaqe të katit të parë 120,6 m², si dhe truall prej 200 m², me vendndodhje në lagjen “{***}”, Fier, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
28. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramentit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti ndodhet në rrethanat e aplikimit të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, gjerat “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer deklarament të rremë në lidhje me përfitimin e pasurisë truall dhe ndërtesë, si dhe ka fshehur pasurinë truall prej 35 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Fier. [...] nga vlerësimi tërësor, duke konsideruar veprimet e vazhdueshme të kryera nga subjekti për përfitimin e pasurisë dhe ndërtesës në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për të justifikuar blerjen e truallit dhe ndërtimin e godinës, duke rezultuar me pamundësi financiare, për periudhën 1994 – 2003, në shumën (-) 2.181.356 lekë dhe për periudhën në vazhdim, 2004-2012, duke vlerësuar përfundimisht se pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit është në shumën (-) 2.377.132 lekë. Në këto kushte, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarament të pamjaftueshëm të kësaj pasurie duke sjellë, për pasojë aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e lexuar në harmoni me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

¹² Shih paragrafin 70, faqe nr. 14 të ankimit të subjektit të rivlerësimit.

29. Këtë konkluzion, në vendimin e tij, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin e përmbledhur se në lidhje me pronësinë e pasurisë objekt vlerësimi, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor në formën e parashikuar nga ligji, përfitimin e saj në një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 163 e vijues të Kodit Civil. Sipas Komisionit, ndonëse subjekti pretendoi se këtë pasuri e ka përfituar nëpërmjet aktmarrëveshjes së vitit 1998 nga shtetasja Z. M., ai nuk arriti të provojë lidhjen e kontratës së shitblerjes dhe regjistrimin e saj, me qëllim që veprimi juridik të njihej sipas legjislacionit në fuqi, nenet 83 dhe 750 të Kodit Civil. Nga ana tjetër, Komisioni argumentoi se, me veprime aktive e duke shfrytëzuar dispozitat ligjore në lidhje me vërtetimin gjyqësor të fakteve, rregulluar nga neni 388 i Kodit të Procedurës Civile, subjekti i rivlerësimit ka arritur të vërtetojë faktin e pronësisë mbi pasurinë, pa qenë në asnjë nga rastet e parashikuara nga kjo dispozitë ligjore dhe, për më tepër, ta regjistrojë atë në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil. Në lidhje me faktin e ndërtimit të shtëpisë, Komisioni arsyetoi se subjekti dështoi të provonte disponimin e lejeve teknike (sheshi dhe ndërtimi) të nevojshme, sikurse deklaruar dhe se, si pasojë, gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, u ngritën dyshime të arsyeshme në lidhje me fiktivitetin e lejes së përdorur nga subjekti në procesin gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronësisë së truallit dhe shtëpisë së banimit, nisur nga të dhënat kontradiktore të konstatuara në dokumentet leje sheshi dhe planimetria bashkëlidhur, për të cilat subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të tregonte konsistencë në deklaratimet e tij, duke kryer deklaratime të ndryshme në deklaratat e pasurive gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në prapësimet përfundimtare me dërgimin e rezultateve të hetimit, në lidhje me mënyrën e përfitimit të pasurisë objekt vlerësimi, duke e bërë të pabesueshëm deklarinimin e tij deri në nivelin e një deklarimi të rremë.
30. Në lidhje me pasurinë truall prej 35 m², Komisioni, në vendimin objekt kontrolli, çmoi se kjo pasuri në fillim ka figuruar pjesë e pasurisë truall dhe ndërtesë dhe, në vijim, është ndarë truall prej 400 m² dhe pjesa tjetër prej 35 m² truall. Sipas Komisionit, pavarësisht se subjekti pretendoi se kjo pasuri nuk është e tij, fakti që është regjistruar në emër të tij, pohimi nga vetë subjekti se pasuria është pjesë e pandarë e truallit ku është ndërtuar shtëpia e banimit, e rrethuar me mur rrethues dhe, nga ana tjetër, mosmarrja e ndonjë veprimi apo mospërdorimi i ndonjë mekanizmi ligjor nga ana e subjektit me qëllim heqjen/fshirjen e kësaj pasurie nga regjistri në pronësi të tij, u vlerësuan si rrethana të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti e ka poseduar dhe gëzuar këtë pasuri ndër vite pa titull dhe, për rrjedhojë, ka pasur detyrimin e deklarinimit në deklaratën e pasurisë përkatëse dhe atë *vetting*. Duke vlerësuar në vijim të këtij arsyetimi se, me veprime dhe mosveprime përkundrejt kësaj pasurie, subjekti ka kryer fshehje të pasurisë truall prej 35 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Fier, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
31. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të mësipërm të Komisionit lidhur me këtë pasuri, ka pretenduar se:
- 31.1. Ai në asnjë rast nuk ka kryer veprime fiktive për përfitimin e kësaj pasurie apo fshehjen e saj. Pronësia e kësaj pasurie, sipas subjektit të rivlerësimit, është përfituar nëpërmjet aktmarrëveshjes së vitit 1998 nga shtetasja Z. M., si dhe vërtetimi i faktit juridik nëpërmjet një

vendimi gjyqësor. Subjekti shprehet në ankim se në deklarin e parë të kryer prej tij në ILDKPKI, ai ka deklaruar shtëpi banimi në ndërtim e sipër me të njëjtin numër regjistrimi hipoteke, sikurse është referuar në notën e transkriptimit të vendimit të gjykatës, por duke cituar si mënyrë përfitimi pronësie të truallit, blerje nga shtetasja Z. M.. Sipas subjektit të rivlerësimit, zonja Z. M. shtëpinë e ka ndërtuar me leje të organeve kompetente me shesh dhe leje ndërtimi, duke theksuar se, meqenëse ajo nuk e ka regjistruar në hipotekë, i është drejtuar gjykatës me qëllim regjistrimin e saj. Subjekti pretendoi gjithashtu se ndërtimi i shtëpisë nga vetë ai dhe vëllai i tij dhe regjistrimi i këtij ndërtimi bazuar në lejen e legalizimit, pavarësisht disponimit të lejeve teknike të nevojshme, është fakt i pakundërshtueshëm.

31.2. Konkluzioni i Komisionit se: *veprimet e subjektit me qëllim përfitimin e pasurisë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si dhe sjellja e tij gjatë procesit të rivlerësimit me deklarime të pabazuara, me qëllim justifikimin e veprimeve të ndërmarra nga ana e tij, nuk i përshtaten aspak figurës së një magjistrati, [...] që cenojnë besimin e publikut te magjistrati* – është i pambështetur jo vetëm në faktet e rezultuara nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ, por nuk mbështetet as në parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës. Subjekti pretendoi se konkluzioni i Komisionit se ai ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit dhe vetë ligjin nr. 84/2016.

31.3. Konkluzioni i Komisionit se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë truall prej 35 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Fier, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, është tërësisht i pabazuar. Subjekti pretendoi se nuk e ka ditur se kjo pasuri është në emër të tij, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të regjistruar këtë pasuri në emër të tij (Agjencia Shtetërore e Kadastrës e ka regjistruar pa titull) dhe, për këtë arsye, nuk mund të ketë përgjegjësi pa faj. Subjekti pretendoi në ankim se për shkak të kësaj shtate të konstatuar, ka kërkuar çregjistrimin e kësaj pasurie nga regjistrat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “AShK”) sepse ai nuk ka titull pronësie mbi këtë pasuri. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur, në cilësinë e provës së re në proces, edhe një deklaratë noteriale dhe aplikimin pranë zyrave të AShK-së për çregjistrimin e kësaj pasurie që figuron e regjistruar në emrin e tij.

31.4. Analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit lidhur me vlerësimin e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, është e gabuar. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit prapësoi se:

(i) Vlera e ndërtimit të banesës deri në vitin 2003, duhet të përlllogaritej në shumën 2.000.000 lekë së bashku me çmimin e truallit, ashtu siç është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003.

(ii) Shpenzimet e kryera për këtë banesë në vitet 2004-2013, duhet të përlllogariten në shumën 3.030.000 lekë, ashtu siç ato janë deklaruar me vërtetësi në deklaratat periodike vjetore apo gjatë hetimit administrativ, për shkak se ato janë shpenzimet reale të kryera, shpenzime të cilat u afrohen kostove mesatare të ndërtimit në vite nga Enti Kombëtar i Banesave, duke zbritur nga kjo koston e zërave të shpenzimeve të cilat nuk janë pjesë e kostove në ndërtimet informale (referuar edhe praktikës së Kolegjit).

(iii) Shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – 1999, janë përlllogaritur në masën 66%, ndryshe nga sa ka orientuar KPA-ja në masën 30% në vendimin nr. 15/202...¹³.

(iv) Shpenzimet e jetesës së djemve, edhe kur ata kanë jetuar në Tiranë, duhet të përlllogariten sipas shpenzimeve të INSTAT-it, referuar parimit të barazisë para ligjit, dhe në këto vite si shpenzime shtesë, duhet të përlllogariten vetëm shpenzimet e qirasë në shumën 5.000 lekë në muaj për secilin, gjatë 9 muajve që vazhdonte shkolla.

(v) Nga muaji korrik i vitit 2013 e në vazhdim, në analizën financiare duhet të përfshihen vetëm shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, pasi fëmijët janë ndarë nga trangu familjar. I njëjti pretendim ngrihet edhe për pasuritë e krijuara prej tyre dhe të regjistruara më vete në regjistrat publikë.

(vi) Shpenzimet e qëndrimit në Gjermani të djalit të subjektit E. A. duhet të përgjysmohen për shkak se ai nuk ka shkuar si turist, por për studime. Gjetja e familjes në Gjermani, marrëveshja me universitetin dhe çdo gjë tjetër është organizuar nga universiteti.

32. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtuara në ankim, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes dhe arsyetimin e Komisionit në vendim, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

- *Lidhur me saktësinë e deklaramit të kryer nga subjekti i rivlerësimit mbi origjinën e pasurisë objekt kontrolli:*

33. Nga shqyrtimi i deklaratës së pasurisë *vetting* dhe deklaratës për herë të parë para ILDKPKI-së, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit deklarimin mbi truallin në të cilin është ndërtuar shtëpia e banimit, duket ta ketë kryer në funksion të deklarimit të burimit të krijimit të pasurisë dhe evidentimit të shpenzimeve të kryera për krijimin e saj (deklarim ky që vjen në harmoni edhe me deklarimin në deklaratën për herë të parë), teksa ka deklaruar se truallin e ka blerë në vitin 1998, me një vlerë prej 380.000 lekësh, sipas aktmarrëveshjes, dhe mbi këtë truall ka ndërtuar shtëpinë e banimit me kursimet familjare ndër vite, duke përcaktuar në rubrikën përkatëse edhe vlerën totale të pasurisë prej 6.000.000 lekësh.

34. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, në kuadër të detyrimit të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur dokumentacionin që justifikon vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, referuar inventarit të dokumentacionit justifikues/shoqërues të deklaratës së pasurisë *vetting*, ka depozituar, ndër të tjera, edhe aktet:

(i) Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier nr. {***}, datë 09.07.1998, me anë të të cilit është vendosur pranimi i padisë së paditësit Hysen Ajasllari dhe detyrimi i palës së paditur Bashkisë Fier të njohë pronar paditësin mbi tokën truall me sip. 400 m² dhe shtëpinë e

¹³ Nuk është specifikuar viti nga ana e subjektit.

banimit të ndodhur në lagjen “{***}” të qytetit të Fierit [...]. Vendimi citohet të ketë marrë formë të prerë më datë 15.01.2009¹⁴.

(ii) Notë transkriptimi nr. {***} regjistri të Zyrës së Hipotekës Fier, të lëshuar në favor të z. Hysen Ajasllari kundër Bashkisë Fier, në të cilën thuhet: *Me vendimin civil të Gjykatës së Rrethit Fier, nr. {***}, datë 9.7.1998, është vendosur njohja pronar e Hysen Ajasllarit mbi një sipërfaqe toke prej 400 m² dhe shtëpinë e banimit të ndodhur në lagjen “{***}”, Fier. Shtëpia është njëkatëshe, e përbërë nga një dhomë e kuzhinë, aneks, korridor, banjë me konstruksion themele betoni [...]. Transkriptohet në numrin {***} të regjistrin të pronësisë private, indeks {***}, në Fier, sot në datën 12.10.1998.*

(iii) Certifikatë pronësie e pasurisë tokë truall me sipërfaqe 400 m² dhe ndërtesë me sip. 107 m², lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 23.01.2009, shoqëruar me kartelën e pasurisë, regjistrim ky në dukje i kryer pasi vendimi i mësipërm gjyqësor ka marrë formë të prerë.

(iv) Shkresë e Drejtorisë së ALUIZNIT Fier 1, nr. {***} prot., datë 29.01.2013, drejtuar ZVRPP-së Fier, me objekt “Dorëzim dokumentacioni”, nga ku konstatohet se është përcjellë praktika e legalizimit të objektit me nr. {***} dosjeje.

(v) Certifikatë pronësie nr. {***}, datë 11.02.2013, shoqëruar me kartelën përkatëse të pasurisë, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij S. A. janë bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme tokë truall me sip. 400 m² dhe ndërtesë me sip. 189,6 m², regjistrim i kryer pas lëshimit të lejes së legalizimit nr. {***}, datë 22.01.2013.

(vi) Kartelë e rifreskuar pasurie, sipas së cilës, në vijim të regjistrimit të kryer më datë 04.03.2013, me nr. ref. {***} të kontratës së “Pjesëtimit të pasurisë”, në emër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar pasuria me nr. {***}, e llojit tokë truall 200 m² dhe nga kjo sipërfaqe toke, 99,6 m² janë ndërtesë. Në përshkrimin e veçantë evidentohet se ndërtesa është një godinë dykatëshe banimi ku kati përdhe ka sip. 99,6 m² dhe kati i parë sip. 120,6 m². Certifikata e pronësisë mbi këtë pasuri, rezulton të jetë lëshuar më datë 04.03.2013.

35. Në deklaratën për herë të parë para ILDKPKI-së, të dorëzuar në datën 23.03.2004, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri si shtëpi banimi në ndërtim e sipër, me pjesë takuese 50%, me vlerë 2.000.000 lekë dhe në rubrikën e të dhënave në regjistrin e hipotekës, ka deklaruar: {***}, {***}, 12.10.98, të dhëna këto të cilat, si evidentuar më sipër, i përkasin notës së transkriptimit në regjistrin e pronësisë private pranë ZVRPP Fier, të vendimit të Gjykatës së Rrethit Fier nr. {***}, datë 9.7.1998, për njohjen pronar të subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllarit, mbi sipërfaqen e tokës prej 400 m² dhe shtëpinë e banimit të ndodhur në lagjen “{***}”, Fier. Gjithashtu, në rubrikën e burimit, subjekti rezultoi të ketë deklaruar “blerë nga shtetasja Z. M. (trualli), kursime”.

36. Trupi gjykues vëren se gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes 1.1 të pyetësorit nr. 2, teksa i është kërkuar depozitimi i aktit të shitblerjes së truallit nga

¹⁴ Nuk ka qartësi nga aktet se përse vendimi ka marrë formë të prerë pas një periudhe kaq të gjatë.

shtetasja Z. M., ka dorëzuar një aktmarrëveshje të lidhur më datë 17.06.1998, mes znj. Z. M. dhe z. Hysen Ajasllari, të cilët konstatohet të kenë rënë dakord për sa në vijim: *Unë, Z. M., kam në pronësi një sipërfaqe toke truall prej 400 m², të ndodhur në “{***}” të qytetit të Fierit, të kufizuar me I. M., jugu me rrugë lagje nga lindja dhe perëndimi me rrugë lagje. Mbi këtë sipërfaqe toke truall të sipërshënuar, është ndërtuar një shtëpi banimi e përbërë nga një dhomë e korridor, e cila është e papërfunduar. Banesa e sipërshënuar është pronë ekskluzive e imja. Këtë sipërfaqe tokë truall dhe ndërtesën e sipërshënuar, unë, shtetasja Z. M., jam dakord që t’ia shes në të ardhmen me dokumente të rregullta me akt noterial z. H. M.. Për realizimin në të ardhmen të shitblerjes së truallit dhe objektit të sipërshënuar si garanci, unë kam marrë si kapar nga z. Hysen Hajasllari shumën 380.000 lekë të reja. [...] Unë Hysen Hajasllari deklaroj se i kam dhënë sot, më datë 17.06.1998, Z. M., si kapar, shumën prej 380.000 lekësh të reja për realizimin në të ardhmen me dokumente të rregullta të shitblerjes së 400 m² truall dhe të ndërtesës prej një dhome e korridor.*

37. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar situatën faktike dhe atë juridike lidhur me pronësinë e tokës truall mbi të cilin është kryer ndërtimi i godinës dykatëshe, e legalizuar në vijim në emër të tij dhe vëllait të tij, duke mos fshehur asnjë fakt, ndonëse deklarimi i tij e ka ekspozuar atë në drejtim të evidentimit të manovrave të kryera për regjistrimin e pronësisë së truallit mbi të cilin ngrihet shtëpia e banimit. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues çmoi se nga analiza e akteve të fashikullit të çështjes, sa deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si një rikonfirmim i deklaramit të subjektit edhe në deklarimet e tij para ILDKPKI-së ndër vite, nuk vlerësohet si deklarim i rremë i tij në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, duke qenë se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht manovrave të kryera për regjistrimin e pronësisë, është treguar transparent dhe ka deklaruar me vërtetësi faktet në lidhje me këtë pasuri, përfshirë dhe shpenzimin e kryer për blerjen e truallit nëpërmjet kontratës së kaparit. Subjekti nuk duket as të ketë fshehur ndonjë të dhënë, fakt apo akt i cili të ketë rezultuar vetëm në saje të hetimit të kryer nga Komisioni, përkundrazi sa rezulton të jetë administruar gjatë hetimit, ishte përcjellë edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, përfshirë edhe leja për shesh ndërtimi e dyshuar nga Komisioni si një dokument fiktiv i përdorur gjatë procesit gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik.
38. Sa i takon qëndrimin të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe deklarimeve të tij lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë mbi truallin në të cilin është ngritur ndërtesa, trupi gjykues konstaton se, në përfundim të hetimit, gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna ndaj pyetjeve të relatores, duket të ketë bërë *mea culpa* teksa është shprehur se: *Në vitin 1998, e kam marrë me anë të një aktmarrëveshjeje e cila është depozituar, por sqaroj se ky truall është blerë nga personi të cilit ia kam blerë, në vitin ‘92, troje të ndara nga bashkia. [...] Jam interesuar, jam bindur që këto kanë qenë troje të rregullta, të ndara nga bashkia dhe pastaj kam bërë atë aktmarrëveshje se unë banoja në Skrapar në atë kohë. [...] Tani unë nuk di ta shpjegoj më shumë, po këtë e them me çiltërsi dhe kështu ka ndodhur, këto gjyqe në atë kohë bëheshin me përfaqësues të bashkisë. Përfaqësuesi i bashkisë paraqitej në gjyq edhe konfirmonte zonën, truallin, lejen, d.m.th., si bëheshin në atë kohë... domethënë unë nuk kam shumë dijeni si është bërë, e di që është bërë shkelje e ligjit, është një ngjarje që ka ndodhur 25 vjet përpara dhe unë nuk kam shpëtuar dot nga rrjedha, domethënë siç kanë bërë gjithë të tjerët, kam*

bërë edhe unë, është gabim, e kuptoj, domethënë me të drejtë këto vendime nuk janë marrë në konsideratë [...].

39. Veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për njohjen e pronësisë mbi truallin nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe të dhënat e deklaruara në kërkesëpadinë e depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier mbi pasjen e lejeve nga autoritetet përkatëse për ndërtimin e shtëpisë 1-katëshe mbi truallin e përfutur me shesh ndërtimi (të cilat nuk u konfirmuan gjatë hetimit administrativ të jenë lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit) leje këto të cilat edhe pse nuk përjashtohet të jenë lëshuar në emër të Z. M., si pretenduar në ankim nga subjekti i rivlerësimit, nuk u provuan gjatë hetimit administrativ në Komision dhe as gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, vlerësohen nga trupi gjykues si veprime të cilat, si me të drejtë konstatuar nga Komisioni, janë të papranueshme për një funksionar të drejtësisë dhe cenojnë integritetin dhe etikën e tij. Megjithatë, trupi gjykues, në vijim të analizës së mësipërme lidhur me vlerësimin e situatës faktike për krijimin e pasurisë së llojit “truall me sip. 400 m²”, parë në kuadër të veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit për njohjen juridike të faktit të pronësisë dhe kontekstit historik në të cilin janë zhvilluar këto ngjarje, periudhën e hershme në të cilën kanë ndodhur këto fakte, si dhe mungesës së evidentimit nga hetimi të sjelljeve apo veprimeve të së njëjtës natyrë për periudhën në vazhdim, në dritën edhe të qëndrimit pranues dhe reflektues të subjektit të rivlerësimit lidhur me veprimet e tij, çmoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se e qortueshme dhe e papajtueshme me rolin e tij si funksionar i sistemit të drejtësisë, nuk mund të ngrihet në nivelin e një sjelljeje që ka cenuar besimin e publikut në të tillë nivel që të justifikojë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
40. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit për fshehje të pasurisë “truall” me sipërfaqe totale 35 m², në lagjen “{***}”, Fier, pjesë e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi se qëndrimi i Komisionit është i paqartë, për sa kohë në konkluzionin e dhënë për pasurinë objekt kontrolli¹⁵, duket se ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë truall prej 35 m², bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, duke rikonfirmuar këtë konkluzion edhe në konkluzionin e parashtruar në paragrafin 28.9 në vijim, sipas të cilit: *subjekti ndodhet në rrethanat e aplikimit të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, gjerat “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer deklarim të rremë në lidhje me përfitimin e pasurisë truall dhe ndërtesë, si dhe ka fshehur pasurinë truall prej 35 m², në “{***}”, Fier. Ndërkohë që në konkluzionin përfundimtar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të parashtruar në paragrafët 68 dhe 68.1, Komisioni është shprehur: *Trupi gjykues, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e subjektit dhe analizoi provat e paraqitura në mbështetje të shpjegimeve të tij, çmon se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës në lidhje me krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve me burime të ligjshme të ardhurash në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën (-) 5.320.076 lekë, sipas nenit 33, pika 5, germa “b”. Subjekti ka kryer deklarime jo në përputhje me ligjin, deklarime të rreme, si dhe ka ndërmarrë veprime të cilat**

¹⁵ Shih paragrafët 28.8 dhe 28.9 në faqen 13 të vendimit.

rezultuan se nuk i përshtaten aspak figurës së një magjistrati, duke sjellë për pasojë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, shkaqe këto të cilat justifikojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pikat 3 dhe 5, si dhe nenit 33, pika 5, gerrat “a”, “b” dhe “ç”. Dukshëm në këtë konkluzion final të Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, mungon kualifikimi juridik “fshehje e pasurisë”, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

41. Përveç mospërputhjes së evidentuar si më sipër në vendimin objekt ankimi, lidhur me konkluzionin mbi pasurinë “truall” me sip. 35 m², nga kontrolli i ushtruar në aktet e fashikullit, në kuadër të verifikimit edhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për shkelje procedurale, si pasojë e moskalimit të barrës së provës si parashtruar në shkakun e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit në Komision¹⁶, trupi gjykues konstatoi se në “Rezultatet e hetimit administrativ”, referuar trajtimit të pasurisë së paluajtshme “shtëpi banimi” me sipërfaqe të katit përdhes 99,6 m² dhe sipërfaqe të katit të parë 120,6 m², si dhe truall prej 200 m², me vendndodhje në lagjen “{***}”, Fier, Komisioni, në lidhje me truallin me sip. 35 m² ka evidentuar si gjetje të hetimit administrativ, se subjekti nuk ka kryer deklarimin e pasurisë truall prej 35 m², të paregjistruar me certifikatë pronësie e figuruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme Fier, në emër të subjektit të rivlerësimit, duke i kaluar barrën e provës këtij të fundit vetëm *për të provuar me dokumentacion provues ligjor deklarimin e tij mbi këtë pasuri të pretenduar si jashtë truallit të tij.*
42. Nga shqyrtimi i kujdesshëm i dokumentit të rezultateve të hetimit, nuk rezultoi që mbi këtë situatë faktike të rezultuar gjatë hetimit administrativ, mosdeklarimit të truallit me sip. 35 m², e cila figuronte në emër të subjektit të rivlerësimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme Fier, të jetë bërë një kualifikim i caktuar ligjor, sipas të cilit mbi subjektin e rivlerësimit mund të rëndonin pasoja të caktuara juridike në kuadër të procesit të rivlerësimit, në rast se ai nuk do të arrinte të përmbushte barrën e provës së kaluar, në mënyrë të qartë dhe të shprehur nga Komisioni, për të provuar të kundërtën e sa më sipër kualifikuar prej tij. Nga ana tjetër, mospërputhjet e vetë Komisionit në vendim lidhur me konkluzionin e arritur për pasurinë objekt kontrolli, përforcojnë bindjen e trupit gjykues se vetë Komisioni nuk ka qenë i qartë në fazën e përfundimit të hetimit administrativ nëse kjo gjetje kualifikohej apo jo si fshehje e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, duke mos i kaluar atij për rrjedhojë, në kundërshtim me parashikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, barrën e provës për të provuar të kundërtën e një gjetjeje për të cilën kjo dispozitë përcakton zbatimin e prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në kuptim të sa më sipër, në parim, trupi gjykues çmoi se konkluzioni i Komisionit për fshehje të pasurisë truall prej 35 m², bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, është arritur në saje të një procesi të parregullt ligjor, në kuptim të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, pasi subjekti të rivlerësimit nuk i është dhënë e drejta të dëgjohet dhe të mbrohet gjatë procesit të zhvilluar në Komision, lidhur me këtë kualifikim ligjor të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ.

¹⁶ Shih paragrafët 25-26 më sipër në këtë vendim.

43. Përpos sa më sipër, në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe kontrollit mbi bazueshmërinë në fakte dhe në ligj të vendimit të Komisionit, lidhur me këtë pasuri, në vlerësim të situatës faktike të konstatuar gjatë hetimit administrativ lidhur me regjistrimin në ASHK të kësaj sipërfaqeje toke prej 35 m², e cila ka rezultuar si e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, pa dokument pronësie, trupi gjykues çmoi të evidentojë me peshë faktet dhe rrethanat si më poshtë.

43.1. Referuar komunikimit të Komisionit me ASHK-në¹⁷, kjo e fundit informon se në bazën digjitale të të dhënave që disponojnë, subjekti i rivlerësimit Hysen P. Ajasllari rezulton se ka pasuri në Zonën Kadastrale nr. {***}, në vol. {***}, f. {***}, me nr. pasurie {***}, e llojit truall me sipërfaqe totale 35 m², nga të cilat 35 m² janë truall, e papajisur me certifikatë pronësie. Me shënime në seksionin E: “Sipërfaqja e truallit është jashtë dokumentit ligjor”.

43.2. Trupi gjykues vëren se pasuria e mësipërme me nr. pasurie {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, e llojit truall me sipërfaqe 35 m², me referencë {***}, rrjedh nga pasuria me nr. {***}¹⁸, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, e llojit truall me sipërfaqe 435 m², nga këto 167 m² ndërtesë, e cila, me ref. {***}, është mbyllur dhe është ndarë në vijim në 3 pasuri të paluajtshme. Konkretisht, në pasurinë me nr. {***} që i takon truallit me sip 400 m² me referencë {***}, në pasurinë me nr. {***} ND1 e llojit ndërtesë me sip. 60 m², me referencë {***} dhe në pasurinë e sipërcituar nr. {***}, truall me sip. 35 m² me po të njëjtin nr. reference {***}. Nga verifikimi i akteve bashkëlidhur kësaj shkrese, konstatohet që lidhur me pasurinë me nr. {***}, me pronar Hysen Ajasllari, në planin e rievimit të përgatitur më datë 20.01.2009 nga ing. G. H., rezulton shënimi: S = 400 m², S Nd = 107 m², ndërkohë që në shkresa referohet se pasuria {***} ka pasur sipërfaqe 435 m².

43.3. Në aktet e përcjella nga ZVRPP Fier me nr. reference {***}, sipas së cilave është bërë dhe ndarja e pasurisë {***} në 3 pasuri, ndër to edhe në pasurinë {***}, konstatohet se aktet mbi bazën e të cilave është kryer regjistrimi dhe të cilat rezultojnë të jenë depozituar nga subjekti i rivlerësimit, nuk kanë të referuar ndonjë sipërfaqe totale 435 m² apo 35 m². Aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit janë vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në të cilin citohet në mënyrë të qartë sipërfaqja e truallit prej 400 m², si dhe vendimi për dhënie shesh ndërtimi nr. {***}, datë 26.09.1994, ku përsëri trualli paraqitet me sipërfaqe 400 m². Gjithashtu, konstatohet se mbi notën e transkriptimit të datës 12.10.1998, në të cilën është vënë shënimi {***}, duke iu referuar pasurisë me këtë numër, kuptohet që kjo pasuri referon në sipërfaqen e përcaktuar në vendimin e mësipërm gjyqësor prej 400 m², për të cilin është bërë transkriptimi.

43.4. Nga krahasimi i të gjitha planeve të rievimit të përgatitura në momente të ndryshme kohore, konstatohet se ndërtimi i objektit është brenda sipërfaqes së truallit prej 400 m² dhe se në çdo rast, pasuria {***} truall me sipërfaqe 35 m², paraqitet si një sipërfaqe kufizuese e vijës ndarëse të truallit prej 400 m², në pjesën jugperëndimore të saj, në kufi me rrugën.

¹⁷ Njëpërmjet shkresës drejtuar Komisionit nga ASHK-ja, Drejtoria Fier, me nr. {***} prot., datë 19.11.2020.

¹⁸ Shih shkresën e ZVRPP Fier nr. {***} prot., datë 18.09.2017, drejtuar ZQRPP-së.

43.5. Gjatë procedurës në Komision, subjekti i rivlerësimit, në datën 16.02.2023 ka bërë një kërkesë për informacion pranë AShK Fier, lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë nr. {***}, truall me sipërfaqe 35 m², e cila figuron e regjistruar në emër të tij. Sipas përgjigjes së marrë nga AShK-ja, subjekti i është konfirmuar i njëjti fakt, se pasuria nr. {***} është krijuar nga ndarja e pasurisë mëmë me nr. {***}. Gjatë regjistrimit fillestar, pasuria me nr. {***}, ZK {***}, Fier, është regjistruar në vol. {***}, f. {***}, e llojit të pasurisë truall me sip. totale 435 m², nga të cilat 435 m² truall dhe 167 m² janë ndërtesë në emër të z. Hysen Ajasllari. Në vijim, në bazë të dokumentacionit ligjor teknik të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit për regjistrimin në bazë edhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është bërë ndarja e pasurisë nr. {***} në tri pasuritë si më sipër cituar.

44. Nga analizimi i sa më sipër, është e paqartë se përse pasuria me nr. {***} është regjistruar me sipërfaqe totale prej 435 m², ndërkohë që jo vetëm në dokumentacionin ligjor, por edhe atë teknik (në planin e rilevimit) figuron si më sipër evidentuar me sipërfaqe 400 m². Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin që Komisioni nuk ka vlerësuar në mënyrë objektive faktet e provuara gjatë hetimit administrativ lidhur me regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrat e pasurive të paluajtshme në ZVRPP Fier. Trupi gjykues nuk gjeti asnjë të dhënë nga hetimi administrativ i kryer në Komision në lidhje me dijeninë e subjektit të rivlerësimit mbi përfshirjen e kësaj sipërfaqeje trualli në truallin në pronësi të tij, si dhe nuk konstatoi asnjë fakt ku ai të jetë sjellë si pronar i ligjshëm i kësaj pasurie, ndonëse pa titull pronësie, përpos faktit që edhe pse një sipërfaqe modeste dhe në kufij të truallit në pronësi të ligjshëm të subjektit, banesa e këtij të fundit, e ngritur mbi këtë truall, nuk ka pikëprerje me sipërfaqen prej 35 m², objekt kontrolli sipas këtij shkaku ankimi. Në përfundim, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka fshehur pasurinë truall prej 35 m², në “{***}”, Fier, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, përpos faktit që është rrjedhojë e një procedure në shkelje të së drejtës së subjektit për proces të rregullt, rezultoi e pabazuar në një vlerësim objektiv të fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ.

45. Në këto kushte, aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit në cilësinë e provave të reja, “Deklarata noteriale” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2023, e z. Hysen Ajasllari, si dhe formulari i aplikimit në ZVRPP Fier, me nr. {***}, datë 23.03.2023, për çregjistrimin nga emri i tij të kësaj pasurie të paluajtshme, u çmuan të panevojshme për t’u administruar nga trupi gjykues në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si të parëndësishme për vendimmarrjen, në dritën e konkluzionit të arritur mbi bazën e akteve të fashikullit të çështjes, pavarësisht se, referuar analizës së trupit gjykues mbi pranueshmërinë e tyre si prova të reja në proces, rezultuan se i përmbushnin kriteret formale në këndvështrim të kërkesave të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

• *Lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për të krijuar pasurinë objekt kontrolli:*

46. Në kuadër të kontrollit të konkluzionit të Komisionit mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit në shumën e 2.377.132 lekëve për të justifikuar blerjen e truallit

dhe ndërtimin e godinës, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kundërshtimin e analizës së kryer nga Komisioni në këtë drejtim.

47. Fillimisht, sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi vlerën e ndërtimit të banesës deri në vitin 2003, e cila, sipas tij, duhet të përlllogaritej në shumën 2.000.000 lekë, duke përfshirë edhe çmimin e truallit, siç është deklaruar prej tij në deklaratën periodike të vitit 2003, dhe shpenzimet e kryera në vijim për ndërtimin e kësaj banese në vitet 2004-2013, sipas totalit të vlerës së deklaruar në deklaratat periodike vjetore në shumën 3.030.000 lekë, trupi gjykues vëren se:
48. Në lidhje me përcaktimin e vlerës totale të investimit të kryer për ndërtimin e banesës në pronësi të subjektit të rivlerësimit, Komisioni¹⁹ rezulton të ketë arritur në konkluzionin se vlera e investimit të kryer për pjesën takuese të subjektit, duket të jetë rreth 6.500.000 lekë²⁰, duke e pranuar për pasojë vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, në shumën prej 6.000.000 lekësh, si të përafërt me sa i ka rezultuar nga përlllogaritjet e tij, të cilat rezultojnë të jenë bazuar në përcaktimin e pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit sipas vlerësimit përpjesëtimor të vlerës së investimit të përlllogaritur nga ALUIZNI për efekt të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në kuadër të procesit të legalizimit. Referuar formularit përkatës, kjo vlerë, për të gjithë pasurinë e legalizuar në tërësi (me vetëdeklarues subjektin dhe vëllain e tij), ka qenë 12.089.031 lekë, e cila proporcionalisht ka rezultuar në vlerën e sipërcituar prej 6.500.000 lekësh. Trupi gjykues konstaton se kjo vlerë është llogaritur bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1180, datë 5.8.2008, “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizimin dhe mbledhjen e administrimit të ardhurave të procesit të legalizimit [...]”²¹, sipas kostove mesatare të EKB-së në kohën e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, në rastin konkret në vitin 2012.
49. Në vijim të sa më sipër, Komisioni, në analizën financiare të kryer lidhur me këtë pasuri në vendim, rezulton se për periudhën kohore deri në vitin 2003, ka përlllogaritur si shpenzime të subjektit të rivlerësimit shumën prej 2.000.000 lekësh për ndërtimin e godinës, shumën prej 380.000 lekë për blerjen e truallit, dhe në vijim, për periudhën 2004-2012, diferencën prej 4.000.000 lekësh (6.000.000 lekë – 2.000.000 lekë = 4.000.000 lekë) rezulton ta ketë shpërndarë në mënyrë proporcionale në shumat 444.444 lekë²² për çdo vit, duke përlllogaritur vlerën totale të investimit për këtë pasuri (truall + ndërtim) në shumën 6.380.000 lekë²³.
50. Në vijim të sa më sipër, në kushtet kur gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se në analizë të deklaramëve periodike të subjektit të rivlerësimit, procesverbaleve të përpiluara në kuadër të kontrolleve të ILDKPKI-së²⁴ dhe dokumentacionit të praktikës së legalizimit të ndërtesës të

¹⁹ Shih paragrafin nr. 29.12 të vendimit të Komisionit objekt ankimi.

²⁰ Në poshtëshënimin nr. 42 të vendimit, Komisioni ka shpjeguar se: vlera 12.089.031 lekë / 407 m² x 220,2 m² = 6.540.551 lekë.

²¹ Shih poshtëshënimin nr. 41 të vendimit të Komisionit objekt ankimi.

²² Shuma 4.000.000 lekë ÷ 9 vite = 444.444 lekë.

²³ Vlera 380.000 lekë trualli + 6.000.000 lekë vlera e ndërtimit.

²⁴ Shih procesverbalin e datës 24.10.2008 pranë ILDKPKI-së.

përcjellë nga ALUIZNI, ndërtesa objekt kontrolli rezulton të ketë nisur ndërtimin në vitin 2001 dhe të jetë shtrirë deri në vitin 2012, trupi gjykues konstaton se përllogaritjet e Komisionit mbi përllogaritjen e vlerës së shpenzimit të kryer për këtë ndërtim informal, pa të dhëna dokumentare justifikuese mbi shpenzimet e kryera ndër vite nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë kryer sipas standardit të zbatuar nga Kolegji në raste të ngjashme, ku vlerat e deklaruara vlerësohen në raport me kostot mesatare vjetore për ndërtimet e kryera nga EKB-ja, në periudhat e deklaruara kur janë kryer punimet e ndërtimit.

51. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi të nevojshme të përllogarisë vlerën totale të investuar për këtë objekt, referuar kostove të ndërtimit sipas EKB-së, për periudhën 2001-2012, për sipërfaqen totale të objektit që i takon subjektit prej 220,2 m², duke e përpjesëtuar sipërfaqen e objektit në mënyrë të barabartë për 12 vite²⁵. Sipas kësaj mënyre përllogaritjeje, vlera totale e objektit për periudhën 2001 - 2012, përllogaritet në shumën 5.695.968 lekë, duke rezultuar në këtë mënyrë, vlera e objektit më e ulët se vlera 6.000.000 lekë, duke bërë të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në deklarimin e kësaj vlere investimi, subjekti, ndryshe nga sa ka përllogaritur Komisioni, ka përfshirë dhe vlerën e investuar për blerjen e truallit.
52. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë deklarimin mbi vlerën e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, në shumën 6.000.000 lekë, si dhe parashikimin ligjor të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mbi vlerën provuese të deklaratave periodike, në interpretim të deklarimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën për herë të parë të dorëzuar në ILDKPKI në mars të vitit 2004: [...] *Apartament banimi në ndërtim e sipër, (vlehtë në milionë lekë) 2.000.000, pjesa që zotëron 50%, vendndodhja {***}, Fier ({***}), (nr. dt. regj në hipotekë nëse ka) {***}, {***} 12.10.1998. Burimi: blerë nga shtetasja Z. M. (trualli) kursime – çmuar në harmoni edhe me përllogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj mbi bazën e kostove mesatare të EKB-së, për periudhën e ndërtimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se vlera e investimit të kryer për periudhën deri në vitin 2003, e deklaruar në shumën 2.000.000, përfshin edhe vlerën e shpenzuar për blerjen e truallit.*
53. Sa më sipër, nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 1994 - 2016, vlera e truallit në shumën prej 380.000 lekësh u konsiderua si shumë e përfshirë në vlerën totale prej 2.000.000 lekësh (truall + vlerë investimi për ndërtim shuma 2.000.000 lekë), duke u zëruar ky shpenzim i përllogaritur nga Komisioni si zë i veçantë në analizën e Komisionit. Shpërndarja në mënyrë proporcionale nga Komisioni e vlerës së mbetur të investimit prej 4.000.000 lekësh, si vlerë e shpenzuar çdo vit në shumën prej 444.444 lekësh, për periudhën 2004 -2012, u gjet e drejtë dhe e bazuar në kontekstin e një analize të kryqëzuar të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit mes vlerës totale të pasurisë në deklaratën e pasurisë *vetting* në shumën prej 6.000.000 lekësh dhe deklarimeve të pjesshme mbi shpenzimet e kryera për ndërtim në deklaratat periodike vjetore.

²⁵ Duke përllogaritur për çdo vit sipërfaqen e ndërtimit prej 18,35 m² (220,2 m² ÷ 12 vite = 18,35 m²).

54. Në lidhje me zërin e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1994 – 1999, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ato janë përlllogaritur në masën 66% të të ardhurave, ndryshe nga sa ka orientuar Kolegji në masën 30%, sipas vendimit orientues nr. 15/2021.
55. Trupi gjykues, pasi kontrolloi përlllogaritjen e këtij zëri shpenzimesh nga ana e Komisionit, si dhe verifikoi aktet e fashikullit të çështjes në lidhje me të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit, për të cilin konstatoi se për periudhën e viteve 1994-2003²⁶, ishte trajtuar me të ardhura për ushtrimin e detyrës si prokuror, arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit për përlllogaritje të gabuar të këtij zëri shpenzimesh u gjet i drejtë, i bazuar në fakte dhe në jurisprudencën orientuese të Kolegjit, duke u korrigjuar përkatësisht. Në përfundim, shpenzimet e jetesës për këtë periudhë, u përlllogaritën në masën 30% të të ardhurave të realizuara nga paga, duke rezultuar në shumën prej 564.484 lekësh²⁷.
56. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e jetesës së djemve kur ata kanë jetuar në Tiranë, duhet të përlllogariten sipas shpenzimeve të INSTAT-it, referuar parimit të barazisë para ligjit dhe, në këto vite, si shpenzime shtesë duhet të përlllogariten vetëm shpenzimet e qirasë në shumën 5.000 lekë në muaj për secilin, gjatë 9 muajve që vazhdonte shkolla, trupi gjykues konstatoi si vijon.
57. Nga kontrolli i analizës financiare të përgatitur nga Komisioni për periudhën 2007-2014 në vendimin e Komisionit, rezultoi se në zërin “Shpenzime qiraje/jetese në Tiranë, T., E. dhe F. A.”, janë përlllogaritur shpenzimet e qëndrimit dhe të strehimit për të tre djemtë e subjektit në shumën 33.000 lekë në muaj për person, për 9 muaj të vitit, si dhe në zërin “Shpenzime jetike”, për çdo vit të analizës nuk janë përlllogaritur shpenzime jetese për fëmijët në Fier (për periudhën 9-mujore gjatë kohës së shkollës), duke përlllogaritur shpenzime jetese sipas standardit të INSTAT-it, vetëm për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten. Nga ana tjetër, rezultoi se Komisioni për periudhën 5-mujore (25.11.2010 – 29.4.2011), periudhë kur djali i subjektit E. A. ka qenë në Gjermani, përveç shumës 700 euro në muaj, ka përlllogaritur njëkohësisht edhe shumën prej 33.000 lekësh në muaj (1 muaj në vitin 2010 dhe 4 muaj në vitin 2011), si shpenzime qëndrimi dhe strehimi në Tiranë²⁸, ndërkohë që ai ndodhej në Gjermani.
58. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me çështjen e shpenzimeve të jetesës së fëmijëve gjatë periudhës së shkollimit të tyre në Tiranë, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, e gjeti të drejtë dhe të bazuar analizën e kryer nga Komisioni në lidhje me përcaktimin e këtyre shpenzimeve, të cilat, referuar përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 1 të Komisionit, ishin deklaruar në mënyrë të vullnetshme prej vetë

²⁶ Referuar vërtetimit të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, nr. {***} prot., datë 25.10.2016.

²⁷ Në analizën financiare për periudhën 1994-2003, shpenzimet jetike (periudha 1994-1999, masa 30% e të ardhurave dhe 2000-2003, sipas të dhënave të INSTAT-it), u përlllogaritën në shumën totale 2.583.123 lekë, dhe jo sa Komisioni, në shumën 3.260.503 lekë.

²⁸ Zëri “Shpenzime qiraje/jetese në Tiranë, T., E. dhe F. A.”, në analizën financiare në Komision, është përlllogaritur në vitin 2010 dhe në vitin 2011 në shumën prej 891.000 lekësh (3 persona x 9 muaj x 33.000 lekë = 891.000 lekë).

atij: [...] për sa u përket pagesave mujore, me sa i kujtohet kanë marrë secili rreth 28.000 lekë në muaj dhe për pagesën e qirasë u është dhënë ndihmë financiare prej 5.000 lekësh në muaj për secilin, pasi edhe zona në të cilën kanë jetuar në këto nivele e ka pasur qiranë, si dhe qiranë e kanë ndarë me shokët [...]. Për rrjedhojë, në analizën financiare për periudhën 2007-2014, në zërin “Shpenzime qiraje/jetese në Tiranë, T., E. dhe F. A.”, u përllogaritën të njëjtat vlera si Komisioni, përveç vitit 2010 ku u përllogarit ky shpenzim në vlerën 858.000 lekë²⁹ dhe vitit 2011, ku u përllogarit ky shpenzim në vlerën 759.000 lekë³⁰ pasi u zbritën shpenzimet e përllogaritura në mënyrë të gabuar për personin e lidhur E. A., përkatësisht në vitin 2010 shuma prej 33.000 lekësh dhe në vitin 2011 shuma prej 132.000 lekësh.

59. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përgjysmimin e shpenzimeve të qëndrimit në Gjermani të djalit të subjektit E. A., për shkak se ai ka qenë për studime dhe jo për turizëm, dhe se gjetja e familjes në Gjermani, marrëveshja me universitetin dhe çdo gjë tjetër është organizuar nga universiteti, trupi gjykues, pasi verifikoi analizën financiare të kryer nga Komisioni, si dhe shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes konstatoi se:
60. Komisioni, në analizën financiare për vitin 2010, në zërin “Shpenzime udhëtimi/qëndrimi jashtë vendit”³¹, ka përllogaritur shumën prej 122.153 lekësh (të konvertuar me kursin zyrtar mesatar vjetor sipas Bankës së Shqipërisë në shumën 886 euro³²), dhe në vitin 2011 ka përllogaritur shumën prej 412.134 lekësh (të konvertuar me kursin zyrtar mesatar vjetor sipas Bankës së Shqipërisë në shumën 2.937 euro³³). Komisioni konstatohet të ketë përllogaritur shumën 700 euro (për 1 muaj) në vitin 2010 dhe shumën 2.800 euro në vitin 2011 (700 euro x 4 muaj, viti 2011 = 2.800 euro).
61. Trupi gjykues vëren se kjo përllogaritje e Komisionit vjen në harmoni me deklarin e subjektit mbi shpenzimet mujore të djalit të tij gjatë qëndrimit në Gjermani, sipas të cilit: [...] *djali E. ka shkuar në Gjermani ndërmjet Universitetit Bujqësor (Kamëz), për shkëmbim eksperience, në të cilën ka qëndruar 6 muaj dhe ka jetuar në një familje gjermane për të cilën është paguar 300 euro në muaj (kontrata ka qenë 700 euro në muaj, por 400 euro mbaheshin për shpenzime jetese)*³⁴.
62. Trupi gjykues vëren se ndonëse subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se djali i tij ka qëndruar 6 muaj në Mynih, Gjermani, nga Universiteti Bujqësor Kamëz me shpenzimet e tyre dhe jo të subjektit, nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë akt justifikues lidhur me këtë pretendim as në Komision dhe as në Kolegj. Në këto kushte, në konsideratë edhe të faktit që subjektet e rivlerësimit kanë barrën

²⁹ Nga shuma 891.000 lekë e përllogaritur nga Komisioni – (33.000 lekë x 1 muaj) = 858.000 lekë.

³⁰ Nga shuma 891.000 lekë e përllogaritur nga Komisioni – (33.000 lekë x 4 muaj) = 759.000 lekë.

³¹ Nga verifikimi i të dhënave sipas sistemit TIMS, rezulton se në vitin 2010 dhe në vitin 2011, ka udhëtuar jashtë vendit vetëm E. A. në periudhën 25.11.2010 - 29.04.2011 (asnjë nga familjarët e subjektit ose vetë subjekti nuk ka udhëtuar jashtë vendit), për rrjedhojë ky shpenzim i përket vetëm djalit të subjektit.

³² Duket se Komisioni ka përllogaritur shumën 700 euro si shpenzim qëndrimi + 180 euro kosto e biletës së avionit = 880 euro.

³³ Duket se Komisioni ka përllogaritur shumën 700 euro si shpenzim qëndrimi x 4 muaj qëndrim + 180 euro kosto e biletës së avionit = 2.980 euro.

³⁴ Shih përgjigjet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pyetësoin nr. 1 të Komisionit.

e provës në këtë proces, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar përlllogaritjen e kryer nga Komisioni lidhur me përlllogaritjen e këtij zëri shpenzimesh.

63. Në përfundim të analizës së mësipërme të trupit gjykues mbi bazën e shkaqeve të ankimit lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “shtëpi banimi” me sipërfaqe të katit përdhes 99,6 m² dhe sipërfaqe të katit të parë 120,6 m², si dhe truell prej 200 m², me vendndodhje në lagjen “{***}”, Fier, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* me vlerë totale investimi prej 6.000.000 lekësh, nga kontrolli i kryer në Kolegj në drejtim të verifikimit të saktësisë së deklaramit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën totale të 2.985.168 lekëve, për mbulimin e shpenzimeve të blerjes së truallit dhe financimin e ndërtimit të kryer përgjatë periudhës 1994 - 2012, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Mungesa e burimeve të ligjshme në krijimin e kësaj pasurie do të paraqitej më e lartë nëse trupi gjykues do të kishte qartësi mbi vijimësinë e marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me pronaren e truallit mbi të cilën u ndërtua banesa, znj. Z. M., për sa kohë aktmarrëveshja e lidhur më datë 17.06.1998 mes tyre, përcaktonte vetëm vlerën e paguar si kapar, pa identifikuar çmimin e shitblerjes për pasurinë truell dhe ndërtesë.
64. Lidhur me *shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë së paluajtshme të llojit “njësi tregtare”, me sipërfaqe 44,2 m², me vendndodhje në Yzberisht, Tiranë*, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
65. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se *subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës në lidhje me pamundësinë financiare të tij dhe personit të lidhur me të për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurisë dyqan në Yzberisht, në vlerën 24.300 euro. [...] Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e pamundësisë financiare për të krijuar gjendjen cash për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012, si burimin kryesor për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke rezultuar me balancë negative në shumën (-) 1.923.027 lekë. Si përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë njësi tregtare në Yzberisht, Tiranë, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
66. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm të kësaj pasurie si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për pagesën e çmimit të blerjes së dyqanit dhe pretendoi se nga analiza e burimeve të krijimit të kësaj pasurie të deklaruar prej tij, përkatësisht: (i) gjendje *cash* në shumën prej 1.850.000 lekësh, e krijuar sipas tij me burime nga të ardhurat e ligjshme të realizuara nga shitjet e pasurive të paluajtshme në Çorovodë, në vitet 2007 dhe 2011; dhe (ii) kredia e marrë pranë Bankës Intesa Sanpaolo në shumën prej 1.000.000 lekësh në vitin 2014 – subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, rezulton me balancë pozitive.

67. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstatoi se ato lidhen vetëm me analizën financiare të kryer nga Komisioni në drejtim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi të marrë në analizë burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, nga ku konstatoi si vijon.
68. Subjekti, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar lidhur me këtë pasuri: *Blerje dyqani me sip. 44,2 m² në Yzberisht, me vlerë 24.310 euro, me burime gjendja e cash-it i deklaruar më parë si dhe kredi INSP*. Në deklaratën periodike të vitit 2014, ka deklaruar: *Blerje dyqani, me sipërfaqe 44,2 m², Yzberisht, Tiranë; vlera e pasurisë 24.310 euro; burimi: gjendja e parave të deklaruara në vitet 2008, 2010, 2012, si dhe kredia e marrë në Intesa Sanpaolo Bank, datë 29.08.2014*. Gjatë hetimit administrative në Komision, subjekti ka rikonfirmuar deklarinimin në deklaratën periodike të vitit 2014 mbi përdorimin e kursimeve gjendje *cash* të deklaruara në vitet 2008, 2010 dhe 2012, duke shpjeguar edhe se *në vitin 2007, kam shitur apartamentin e ndodhur në Skrapar, në shumën 1.500.000 lekë. Nga shitja e ndërtesës (lokalit) të ndodhur në Skrapar, me sipërfaqe 51 m², në shumën 1.200.000 lekë. Kësti i dytë, vlera 7.200 euro, është marrë kredi në Intesa Sanpaolo Bank, në vlerën 1.000.000 lekë. Shuma prej 2.300 eurosh janë kursimet e vitit 2014*.
69. Referuar deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike, kursimi gjendje *cash* i akumuluar deri në fund të vitit 2013, përlogaritet në shumën 1.850.000 lekë (950.000 lekë kursim *cash* në vitin 2007; pakësuar kursimet *cash* në vitin 2008 përkatësisht me 250.000 lekë për shpenzime mobilimi dhe me 250.000 lekë për shpenzime për punime ndërtimi; shtuar kursime *cash* me 200.000 lekë në vitin 2010 dhe me 1.200.000 lekë në vitin 2011, gjithsej 1.850.000 lekë).
70. Në kuadër të analizimit të gjendjes *cash* dhe nga verifikimi i kryer mbi burimin e deklaruar të këtyre kursimeve të deklaruara, trupi gjykues konstaton se:
- 70.1. Lidhur me kursimin e deklaruar në vitin 2007, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në Skrapar në vitin 2007, në shumën prej 1.500.000 lekësh, trupi gjykues vëren se analiza financiare e këtij viti rezultoi me balancë pozitive. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mundësi financiare për të krijuar me burime të ligjshme edhe shumën prej 950.000 lekësh, të deklaruar si kursim gjendje *cash* në deklaratën periodike të vitit 2007 (me burim nga të ardhurat nga shitja e apartamentit në Çorovodë).
- 70.2. Në vijim, në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti ka deklaruar se këto kursime janë pakësuar në shumën 500.000 lekë gjatë vitit 2008, duke mbetur deri në fund të këtij viti kursime *cash* me burime të ligjshme në shumën prej 450.000 lekësh.
- 70.3. Sa u takon kursimeve *cash* në shumën prej 200.000 lekësh, të deklaruara në vitin 2010, analiza financiare e vitit 2010 e kryer në Kolegj rezultoi me balancë negative në shumën prej (-) 437.013 lekësh, për rrjedhojë e gjithë shuma e deklaruar nga subjekti si e kursyer, në gjendje *cash*, rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme.

70.4. Sa u takon kursimeve në gjendje *cash* në shumën prej 1.200.000 lekësh, të deklaruara nga subjekti në vitin 2011, kjo shumë u vlerësua në Kolegj se justifikohet me burime të ligjshme. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues mbajti në konsideratë se kjo shumë është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011, si kursim gjendje *cash*, me burim të përcaktuar shprehimisht nga shitja e pasurisë “ndërtim 51m²” në Çorovodë, të cilat janë konsideruar nga Komisioni si të ardhura të ligjshme të vitit 2011, në shumën prej 1.220.000 lekësh, dhe nuk është rezultat i një kursimi nga të ardhurat e tjera të vitit, i cili, sipas metodologjisë standarde, përlllogaritet si mundësi kursimi nga raporti të ardhura/shpenzime të vitit. Kjo optikë bazohet edhe në faktin se kjo pasuri është shitur në datën 21.11.2011 (afër fundit të vitit 2011), i cili bën të besueshëm deklarin e subjektit se i ka kursyer këto të ardhura nga shitja e kësaj pasurie, për rrjedhojë shuma e plotë prej 1.200.000 lekësh u përlllogarit si e krijuar me burime të ligjshme.

71. Në analizë të sa më sipër, nga kursimet *cash* të deklaruara prej subjektit në shumën prej 1.850.000 lekësh, vetëm shuma prej 1.650.000 lekësh rezultoi me burime të ligjshme³⁵ për t’u përfshirë si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt kontrolli. Për rrjedhojë, nga vlera e pasurisë në shumën 3.384.986 lekë³⁶, duke zbritur shumën e burimeve të ligjshme prej 2.650.000 lekësh, si shumatore e gjendjes *cash* të akumuluar deri në vitin 2011 në shumën 1.650.000 lekë dhe kredisë së marrë pranë Intesa San Paolo Bank në shumën 1.000.000 lekë, pjesa e mbetur në shumën 734.986 lekë u vlerësua në raport me mundësinë e kursimit me të ardhurat e vitit 2014.
72. Nga verifikimi i kryer nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në analizën financiare të vitit 2014, trupi gjykues konstatoi një balancë negative në shumën (-)356.393 lekë, për blerjen e kësaj pasurie, si dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë këtij viti financiar.
73. Në përfundim të shqyrtimit të shkakut të ankimit lidhur me *pasurinë e paluajtshme të llojit “njësi tregtare” me sipërfaqe 44,2 m², me vendndodhje në Yzberisht, të blerë në vitin 2014, në shumën 24.310 euro*, nga kontrolli i kryer në Kolegj në drejtim të verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën e (-) 356.393 lekëve, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
74. Lidhur me *pasurinë e luajtshme të llojit automjet, të tipit “Daimler Chrysler 203”, me targë {***}, blerë në vitin 2009, në shumën 1.000.000 lekë*, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
75. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarin dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se: *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz”, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e tij, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa*

³⁵ 450.000 lekë + 1.200.000 lekë = 1.650.000 lekë.

³⁶ Shuma 24.310 euro për blerjen e kësaj pasurie, e konvertuar sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, referuar datave të pagesave në llogari të noterës M. Sh., në shumën totale prej 3.384.986 lekësh (shuma 14.800 euro me kursin e datës 04.08.2014, shuma 7.200 euro me kursin e datës 01.09.2014, shuma 2.310 euro me kursin e datës 10.11.2014).

“b” e ligjit nr. 84/2016, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën (-) 559.495 lekë. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se mbi të ardhurat e pretenduara, si të përfituara nga shitja e automjetit tipit “Mercedes Benz” 200D, me targë {***}, kishte paguar detyrimet tatimore sipas nenit 4, germa “i” e ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Sipas Komisionit, *subjekti gjithashtu nuk arriti të provonte pamundësinë³⁷ financiare për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit në datën 1.6.2009, në vlerën 1.000.000 lekë.*

76. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë automjet dhe analizën financiare të kryer lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e tij. Subjekti pretendoi se Komisioni, në analizën financiare të kryer për blerjen e automjetit objekt kontrolli, ka gabuar në përcaktimin e të ardhurave nga shitja e një tjetër automjeti në pronësi të subjektit në vitin 2009, në shumën e blerjes së tij dhe jo sa përcaktuar në kontratën e shitjes, me arsyetimin se për këto të ardhura, nuk u provuan pagesa e detyrimeve tatimore. Sipas subjektit, vlera e përcaktuar në kontratën noteriale, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit³⁸, përbën vlerë të plotë provuese. Subjekti pretendoi gjithashtu se, referuar legjislacionit tatimor, fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve nga individët (pra, jo kur kryhet si veprimtari tregtare) nuk rezulton të jetë parashikuar si e ardhur e tatueshme. Rrjedhimisht, sipas subjektit, Komisioni ka gabuar në kategorizimin e kësaj të ardhure si e ardhur e tatueshme. Subjekti kërkoi nga Kolegji që në analizën financiare për blerjen në vitin 2009 të automjetit *Daimler Chrysler, tipi 203, targë {***} ({***})*, të përfsihet si e ardhur nga shitja e automjetit të mëparshëm të subjektit, vlera e plotë e përcaktuar në kontratën e shitjes, prej 780.000 lekësh, duke i konsideruar këto të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

77. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi si më poshtë.

77.1. Me anë të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.06.2009, të lidhur para noterit D. L., mes palëve P. Ç. në cilësinë e shitësit dhe Hysen Ajasllari në cilësinë e blerësit është dakordësuar shitblerja e pasurisë së luajtshme e llojit automjet i markës “Daimler Chrysler” tipi 203, prodhim i vitit 2001, me targë {***} (në vijim me targë {***}), të cilën shitësi ia ka shitur subjektit të rivlerësimit përkundrejt shumës 1.000.000 lekë.

77.2. Më parë, gjatë të njëjtit vit, subjekti i rivlerësimit me anë të “Kontratës së shitblerjes së mjetit” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.05.2009, të lidhur përpara noterit G. B. ka shitur automjetin e tipit “Mercedes Benz” 200D, prodhim i vitit 1993, me targë {***} kundrejt çmimit prej 780.000 lekësh. Këtë automjet, subjekti i rivlerësimit rezulton ta ketë blerë sipas kontratës së

³⁷ *Duket si lapsus i Komisionit, qëllimi duket se ka qenë të shprehë se subjekti nuk arriti të përmbysë barrën e provës mbi konstatimin e Komisionit për pamundësinë financiare për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit në datën 1.6.2009, në vlerën 1.000.000 lekë.*

³⁸ *Subjekti ka referuar vendimet e Kolegjit nr. 11/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj, si dhe nr. 5/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit Adriatik Cama.*

lidhur për këtë qëllim më datë 18.08.2004, para noterit të Dhomës së Noterisë Tiranë, P. S. P., përkundrejt pagesës së çmimit prej 250.000 lekësh.

77.3. Në kuadër të hetimit të kryer lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e automjetit “Daimler Chrysler” me targë {***}, konkretisht sa u takon të ardhurave të realizuara nga shitja e automjetit “Mercedes Benz” 200D, me targë {***} (deklaruar si burim krijimi në deklaratën e pasurisë *vetting*), Komisioni ka ngritur dyshime të arsyeshme se: (i) vlera prej 250.000 lekësh, e shënuar si çmim blerjeje në kontratën e datës 18.8.2004, nuk duket se përfaqëson vlerën reale të paguar nga subjekti për blerjen e këtij automjeti; dhe (ii) vlera e shitjes së automjetit prej 780.000 lekësh (pra, rreth 3 herë më shtrenjtë se çmimi i blerjes), sipas kontratës së shitblerjes së datës 21.5.2009, pas 5 vitesh përdorimi/amortizimi të tij, gjithashtu nuk dukej se përfaqësonte vlerën reale të përfituar nga subjekti, duke i kaluar atij barrën e provës për të provuar të kundërtën lidhur me sa më sipër dhe, rrjedhimisht, duke përfshirë në analizën financiare si të ardhur nga shitja vetëm shumën prej 250.000 lekësh, që përfaqësonte çmimin e blerjes në vitin 2004.

77.4. Në përfundim, Komisioni ka arritur në konkluzionin për moskonsiderimin e këtyre të ardhurave si të ligjshme në kuptim të standardit kushtetues të përcaktuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, bazuar në faktin që për diferencën e të ardhurave mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit “Mercedes Benz” 200D, me targë {***}, nuk u provua pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale të realizuara nga shitja.

78. Trupi gjykues, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm në lidhje me përcaktimin e të ardhurave personale që i nënshtrohen tatimit, si dhe në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit lidhur me interpretimin e dispozitave të zbatueshme të ligjit të kohës për tatimin mbi të ardhurat personale, vlerëson të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit nuk i nënshtrohen tatimit dhe, për rrjedhojë, standardi i së ardhurës të ligjshme, vlerësuar vetëm në drejtim të mosprovimit të pagesës së detyrimit tatimor, çmohet i pabazuar në ligj. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues – në vlerësim të situatës faktike lidhur me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ mbi çmimet e përcaktuara në kontratat e blerjes në vitin 2004 dhe atë të shitjes në vitin 2009, të cilat rezultuan me një diferencë në rritje me mbi trefish të vlerës në blerje, për një automjet me vit prodhimi 1993 – arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është i besueshëm në lidhje me vlerën e transaksionit të shitjes dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për të përfshirë në analizën financiare për krijimin e pasurisë objekt kontrolli të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit “Mercedes Benz” 200D, me targë {***}, sipas vlerës së përcaktuar në kontratën e blerjes së tij në vitin 2004, u gjet i drejtë, pavarësisht se bazuar në një arsyetim të ndryshëm të të ardhurave të krijuara nga një transaksion i pabesueshëm shitjeje dhe jo në kontekst të mosprovueshmërisë së pagesës së tatimeve lidhur me to.

79. Bazuar në sa më sipër, nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si ky i fundit, se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën e (–) 559.495 lekëve për krijimin e kësaj pasurie. Trupi gjykues konstatoi se edhe nëse do merrej në konsideratë pretendimi i subjektit për përlllogaritjen e gjendjes

së likuiditetit në fund të vitit 2008, e cila, sipas tij, është përdorur në mes të vitit 2009 duke mbetur e pandryshuar në fund të vitit, subjekti ndonëse do të rezultonte me një pamjaftueshmëri më të vogël burimesh të ligjshme në blerje, në shumën (-) 109.495 lekë, balanca e vitit financiar nga përlllogaritjet e kryera në Kolegj, do të paraqitej më e thellë³⁹ se shuma e përlllogaritur prej (-) 752.877 lekësh, duke u shtuar me 450.000 lekë, sa shuma e kursimeve *cash* të përdorura, duke arritur vlerën negative prej (-) 1.202.877 lekësh.

80. Në përfundim të analizës së mësipërme, lidhur me automjetin e tipit “*Daimler Chrysler 203*”, me targë {***}, të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2009, në shumën prej 1.000.000 lekësh, nga kontrolli i kryer në Kolegj në drejtim të verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën (-) 559.495 lekë, për blerjen e automjetit, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016
81. Lidhur me *shkakun e ankimit për kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit lidhur me krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit automjet të tipit “Benz Mercedes”, me targë {***}, në pronësi të personit të lidhur (djali i subjektit të rivlerësimit) F. A.*, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
82. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramentit dhe verifikimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë automjet të blerë nga djali F. A. për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e tij, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke rezultuar me balancë negative në shumën (-) 442.630 lekë.* Komisioni ka arritur në konkluzionin për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e këtij automjeti nga djali i subjektit të rivlerësimit, pasi ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provonte deklarimin e tij (djalit) në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shërbimet e kryera nëpërmjet platformave të *web-it*.
83. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke pretenduar fillimisht se pavarësisht faktit se kjo pasuri në pronësi të djalit të tij është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2015 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, referuar parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe udhëzimit të dalë në zbatim të tij, si dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, djali i subjektit të rivlerësimit, i cili është ndarë nga trangu familjar në vitin 2013 (dhe rrjedhimisht nuk përfshihet në certifikatën familjare të subjektit të rivlerësimit) nuk përfshihet në rrethin e personave të lidhur që mbartin detyrim për deklarim.
84. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar edhe konkluzionin lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga djemtë e tij nga shërbimet *online*, duke pretenduar se të ardhurat e përfituara nga këto shërbime dhe të paguara nga *Google*, provojnë burimin e ligjshëm të tyre dhe, sa u takon detyrimeve tatimore, ato janë paguar në vendin e origjinës konform ligjit.

³⁹ *Balanca negative e konstatuar prej (-) 752.877 lekësh do të shtohet me shumën prej (-) 450.000 lekësh, duke arritur shumën (-) 1.202.877 lekë.*

85. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton fillimisht se në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur F. A. (djali i subjektit të rivlerësimit) ka deklaruar pasurinë e luajtshme automjet të markës “Daimler Chrysler/203/c220CDI (Benz)”, me targë {***}, të blerë me çmimin 4300 euro, nga këto 3300 euro me burim kursime të vetat nga reklamimet *online* në internet dhe diferencën prej 1.000 eurosh marrë nga vëllai, z. E. A..
86. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për mospërfshirjen në analizën e kryer për subjektin e rivlerësimit të fëmijëve madhorë të tij, të cilët janë ndarë nga trangu familjar në vitin 2013, trupi gjykues, në analizë të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, konkretisht neneve 3, pika 13⁴⁰, 30⁴¹, 31, pika 1⁴² dhe 32, pikat 1 dhe 4⁴³, vlerëson se fëmijët madhorë të subjekteve të rivlerësimit, qofshin apo jo pjesë e certifikatës familjare, kanë detyrim ligjor në kuadër të procesit të rivlerësimit për të plotësuar “Deklaratën e pasurisë së personit të lidhur”, pjesë e deklaratës së pasurisë *vetting*, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 (trajtuar njësoj edhe në kuadër të detyrimeve për deklarim para ILDKPKI-së në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003). Fakti i qenies së fëmijëve madhorë së bashku me prindërit (subjektet e rivlerësimit/subjektet deklaruuese para ILDKPKI-së) apo të ndarë prej tyre, fakt ky objekt deklarimi gjithashtu⁴⁴, mund të mbahet në konsideratë të organeve të rivlerësimit në kuadër të përcaktimit të metodologjisë për konfigurimin e analizës financiare për vlerësimin e pasurive të personave të lidhur (fëmijëve madhorë të ndarë nga subjektet e rivlerësimit), si pjesë e një ekonomie të përbashkët me subjektin e rivlerësimit apo veçmas, por jo sikundër pretendon subjekti për mospërfshirjen e tyre në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në ligj.
87. Në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga djemtë e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe në deklaratat periodike përkatëse, personat e lidhur

⁴⁰ Në nenin 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, ku jepet kuptimi i “personit të lidhur” përcaktohet shprehimisht:

““Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit”.

⁴¹ Në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, “Objekti i vlerësimit të pasurisë”, përcaktohet:

“Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.

⁴² Në nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikohet:

“1. Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së”.

⁴³ Në nenin 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se:

“1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. [...]

4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënesit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

⁴⁴ Shih “Deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe deklarimeve periodike para ILDKPKI-së”.

(djemtë e subjektit të rivlerësimit) kanë deklaruar, ndër të tjera, edhe të ardhura të përfituara nga puna e kryer *online* në *website* “{***}” dhe “{***}”, konkretisht si vijon:

- T. A., llogari në Intesa San Paolo Bank nga {***}, me vlerë 943 euro nga reklamime në internet.
- E. A., reklamime *online* nga {***}, me vlerë 2.812 euro, si dhe reklamime *online* nga *www.{***}.com*, me vlerë 2.319 USD.
- F. A., reklamime *online* në *www.{***}.com*, për vitin 2015, kredituar 1.876 USD.

88. Gjatë hetimit administrativ në Komision, nga verifikimi i dokumentacionit bankar, ka rezultuar se në llogari të personave të lidhur (djemve të subjektit të rivlerësimit) ka pasur disa kreditime në llogaritë e tyre bankare, sipas deklarimeve të kryera prej tyre.

89. Në shpjegimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, lidhur me barrën e provës së kaluar nga Komisioni për paraqitjen e dokumentacionit justifikues për të vërtetuar ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara nga ky aktivitet i djemve të tij, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Për sa u përket kreditimeve në llogaritë e djemve janë më se të verifikueshme si burim fondesh të cilat janë bërë nga një kompani serioze e cila është {***}, ndërkohë për sa i përket pagesës së detyrimeve sipas ligjeve, nëse vendi i origjinës ka taksë më të larta se shteti ku paguhet (shqiptar) në vendin që kanë si burime në këtë rast, {***} ka qendrën për Evropën në Irlandën e Veriut, si dhe taksat e mbajtura në burime janë 25% më të larta se në vendin tonë, për këtë arsye edhe nuk është paguar detyrim, si edhe të ardhurat kanë burim të ligjshëm dhe janë kredituar në bankë sipas rregullave.*

90. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, përveç shpjegimeve të dhëna në Komision lidhur me origjinën dhe pagesën e tatimeve në vendin e origjinës, si më sipër, si dhe depozitimit të lëvizjeve bankare të llogarive të djemve në kuadër të të provuarit të kreditimeve të deklaruara prej tyre, ku përsëkrimi i tyre paraqitet: *Order of {***} SHA*, nuk ka dorëzuar ndonjë dokumentacion tjetër justifikues, as në lidhje me natyrën e shërbimeve të kryera dhe mënyrën e shpërblimit, as në lidhje me përcaktimin e detyrimeve tatimore, masën dhe vendin e kryerjes së tyre, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të shërbimeve të kryera nëpërmjet platformave të ndryshme elektronike.

91. Ndonëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi tatimet e mbajtura në burim nga “{***}” Ltd, të cilat, sipas tij, janë më të larta se tatimi i përcaktuar për këto të ardhura sipas legjislacionit shqiptar dhe, rrjedhimisht, personat e lidhur nuk kanë pasur ndonjë detyrim për pagesë të tatimit në Republikën e Shqipërisë, gjenden në përputhje me parashikimin e nenit 37 “Kreditimi i tatimit të huaj” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”⁴⁵, në konsideratë të faktit

⁴⁵ Në nenin 37, “Kreditimi i tatimit të huaj”, të ligjit nr. nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohej shprehimisht:

“1. Në qoftë se gjatë periudhës tatimore një rezident nxjerr nga burime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë fitime apo të ardhura, tatimi mbi të ardhurat personale apo tatimi mbi fitimin, i pagueshëm nga ai rezident, lidhur me këto të ardhura apo fitime duhet të reduktohet me atë masë të tatimit të pagueshëm mbi këtë të ardhur ose fitim. Masa

se, referuar nenit 7 të të njëjtit ligj, çdo rezident në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohet detyrimit për tatimin e të ardhurave personale gjatë periudhës tatimore për të gjitha burimet e të ardhurave brenda dhe jashtë vendit, përfitimi nga parashikimi i nenit 37 të ligjit të sipërcituar apo dhe nga zbatimi i marrëveshjeve të veçanta bëhet nëpërmjet deklaramit të kryer pranë organit tatimor të të ardhurave të krijuara dhe dokumentimit të tatimit të paguar në vendin e burimit të të ardhurave. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues në lidhje me sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që barrën e provës lidhur me justifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara e mbart subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të bazuar në fakte dhe në ligj konkluzionin e Komisionit për moskonsiderimin e këtyre të ardhurave si të ardhura të ligjshme në kuptim të standardit kushtetues të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

92. Në përfundim të sa më sipër, nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të kryer nga Komisioni nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si Komisioni për mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 442.630 lekë, për blerjen e kësaj pasurie nga personi i lidhur F. A. (djali i subjektit të rivlerësimit), si dhe kryerjen e shpenzimeve deri në datën e blerjes së saj. Trupi gjykues konstaton se nëse analiza për verifikimin e mundësisë financiare për blerjen e këtij automjeti do të kryhej vetëm mbi bazën e të ardhurave të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, pa përfshirë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, kjo pasuri do të rezultonte me mungesë të plotë burimesh në shumën prej 4.300 eurosh, në kushtet kur të ardhurat e djemve rezultuan se nuk përmbushnin standardin e të ardhurës së ligjshme sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
93. Në këto kushte, lidhur me automjetin e tipit “Benz Mercedes C 220”, me targë {***}, në pronësi të personit të lidhur F. A., të blerë në vitin 2015, në shumën 4.300 euro, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit objekt kontrolli, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
94. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit lidhur me të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë së luajtshme të llojit automjet të tipit “Benz Mercedes”, me targë {***}, të blerë në vitin 2014 nga personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit) dhe e shitur në vijim në të njëjtin vit, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
95. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi këtë pasuri të luajtshme, dikur në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk arriti të provonte se mbi të ardhurat e pretenduara, në shumën 320.000 lekë, kishte paguar detyrimet tatimore sipas nenit 4, germa “i” e ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të

e tatimit të huaj të pagueshëm duhet të vërtetohet me dokument autentik, të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

2. Reduktimi i tatimit mbi të ardhurat personale ose tatimi mbi fitimin, i dhënë në paragrafin e parë të këtij neni, nuk duhet të kalojë tatimin e pagueshëm mbi fitimin apo të ardhurat nga burimi i huaj, në rast se këto të ardhura realizohen në Republikën e Shqipërisë [...].”

ardhurat”, i ndryshuar, për t’u konsideruar si e ardhur e ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, Komisioni duke mos i njohur si të ligjshme të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit sipas vlerës prej 320.000 lekësh të përcaktuar në kontratën e shitjes, ka përfshirë në analizën e vitit 2014, si të ardhura të ligjshme nga shitja e automjetit shumë prej 204.000 lekësh të përcaktuar në kontratën e blerjes së automjetit në po të njëjtin vit.

96. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar këtë konkluzion të Komisionit dhe pretendoi se për këto të ardhura nga shitja e automjetit, nuk ka paguar detyrime tatimore për shkak se këto të ardhura nuk përfshihen në gamën e të ardhurave të tatueshme.
97. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi konstatoi se arsyeja e vetme e moskonsiderimit të të ardhurave të realizuara nga shitja e automjetit si të ardhura të ligjshme, është për shkak të mosprovimit të pagesës së detyrimit tatimor, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm të kohës lidhur me tatimin mbi të ardhurat personale, si dhe interpretimit të tij nga Kolegji, referuar jurisprudencës së këtij të fundit për çështje të ngjashme, e gjen të drejtë dhe të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit, ai nuk ndodhej para detyrimit të pagimit të tatimit mbi të ardhurat. Rrjedhimisht, konkluzioni i Komisionit për moskonsiderimin e diferencës mes çmimit të shitjes dhe atij të blerjes së automjetit si e ardhur e ligjshme vlerësohet i pabazuar në ligj. Në këto kushte, çmohet se në analizën financiare të vitit 2014, të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit të tipit “Benz Mercedes”, me targë {***}, duhet të përcaktohen sipas çmimit të shitjes në kontratën e shitblerjes së mjetit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.10.2014.
98. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pambështetur në jurisprudencën e Kolegjit të konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit është ndodhur në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë së luajtshme të llojit automjet të tipit “Volkswagen”, të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2000 dhe të shitur prej tij në vitin 2004, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
99. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se ndonëse subjekti i rivlerësimit në deklaratën për herë të parë në vitin 2004, ka deklaruar: *Autoveturë, tip “Volkswagen”, viti i prodhimit 1975, vlera 370.000 lekë, prill 2000 blerë, kursime, çmimi i blerjes së këtij automjeti, referuar kontratës së shitblerjes së tij me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.5.2000, ka qenë 530.000 lekë.* Komisioni, pasi i ka vlerësuar jobindëse shpjegimet e subjektit lidhur me këtë mospërputhje, ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka deklaruar saktë, në përputhje me ligjin, pasurinë objekt vlerësimi, duke e bërë, për rrjedhojë, deklarimin e tij të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pikat 3 dhe 33 dhe pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
100. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankimin e tij se, lidhur me pasaktësinë në deklaratën periodike të vitit 2003, lidhur me çmimin e automjetit të blerë prej tij në shumë të 530.000 lekëve, por të deklaruar në shumë të 370.000 lekëve, Kolegji ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar sa i takon qëndrimin se pasaktësitë në deklaratimet vjetore nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës

disiplinore⁴⁶ dhe, për rrjedhojë, këto pasaktësi nuk mund të klasifikohen si deklaram i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

101. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi konstatoi se me të drejtë Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën për herë të parë në lidhje me deklarimin e çmimit të një pasurie të luajtshme në pronësi të tij në periudhën kohore 2000-2004, vlerësoi gjithashtu se në analizë të legjislacionit të zbatueshëm mbi procesin e rivlerësimit kalimtar, si dhe jurisprudencës së Kolegjit në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i kësaj pasurie nuk sjell asnjë pasojë në drejtim të vlerësimit të saktësisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit, duke qenë se për këtë pasuri, për të cilën titulli i pronësisë ka humbur që në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në kushtet e detyrimit ligjor për deklaram në deklaratën e pasurisë *vetting*. Rrjedhimisht, pasaktësia e konstatuar në deklaratën për herë të parë për një pasuri, e cila nuk ishte në pronësi të subjektit të rivlerësimit në kohën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, nuk mund të çojë në kualifikimin juridik të kësaj situate faktike, si deklaram i pamjaftueshëm në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
102. Trupi gjykues vlerëson se e vetmja pasojë që krijohet nga pasaktësia e konstatuar në deklaratën për herë të parë, është e natyrës financiare, duke përfshirë në analizën e kryer, si çmim të blerjes së automjetit në vitin 2000, vlerën e konstatuar sipas kontratës së shitblerjes dhe jo atë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, çka rezulton të jetë realizuar nga Komisioni dhe të mos jetë kundërshtuar as nga subjekti i rivlerësimit.
103. *Lidhur me dhurimin e deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting dhe atë periodike të vitit 2016, nga djali i subjektit të rivlerësimit E. A., në shumën 3.000 euro, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë dhurim dhe pretendoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive, sipas parashikimeve të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për të vërtetuar burimin e ligjshëm të parave të dërguara nga znj. I. E. për shkak të rrethanave specifike të rastit, ndonëse analiza financiare e këtij viti ka rezultuar pozitive.*
104. Lidhur me shqyrtimin e këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren fillimisht se Komisioni lidhur me këtë dhurim të deklaruar në shumën 3.000 euro nga shtetasja I. E., të realizuar me disa transferta nëpërmjet Western Union, ka arsyetuar në vendimin objekt ankimi se subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara si të dhuruara dhe, për rrjedhojë, shuma e dhuruar prej 3.000 eurosh nuk është konsideruar në analizën financiare. Në përfundim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk ka deklaruar saktë, në përputhje me ligjin, pasurinë objekt vlerësimi, duke e bërë për rrjedhojë deklarimin e pamjaftueshëm në kuptim të neneve 61, pika 3 dhe 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
105. Në analizë të sa më sipër, si dhe referuar parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren se, nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të

⁴⁶ Subjekti ka referuar vendimin e Kolegjit nr. 10/2022 që i përket subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj.

rivlerësimi se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Nga verifikimi i akteve të fashikullit, nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur provë të pamundësisë së kontaktimit me I. E., apo të ketë shpjeguar rrethanat specifike të rastit konkret, të cilat pretendon si pengesë për mosrealizimin e provës dokumentare lidhur me ligjshmërinë e burimeve të këtij dhurimi, por duket të jetë mjaftuar vetëm me shpjegimin e dhënë në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit se: [...] *aktualisht është e pamundur se djali ka humbur çdo kontakt me personin në fjalë [...]*.

106. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e këtij dhurimi të deklaruar nga djali i subjektit, mbetet i pacenuar dhe burimet e ligjshme të dhurimit të paprovuara, ndonëse kjo situatë nuk duket të prodhojë një pasojë negative, duke qenë se rezultati financiar i vitit 2016 paraqitet pozitiv.
107. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën e vlerësimit 2003-2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në periudhën 1990 – 2003, në shumën (-) 920.095 lekë; në vitin 2005, në shumën (-) 147.056 lekë; në vitin 2006, në shumën (-) 252.487 lekë; në vitin 2008, në shumën (-) 198.415 lekë, në vitin 2009, në shumën (-) 752.877 lekë; në vitin 2010, në shumën (-) 437.013 lekë; në vitin 2011, në shumën (-) 324.324 lekë; në vitin 2012, në shumën (-) 99.957 lekë; në vitin 2014, në shumën (-) 156.393 lekë dhe në vitin 2015, në shumën (-) 480.855 lekë. Në total, mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në periudhën e rivlerësimit 2003-2016, është në shumën e (-) 3.769.475 lekëve.
108. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pambështetur në provat e administruara, si dhe në *parashikimet ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, të konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë*, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
109. Subjekti i rivlerësimit e mbështet këtë shkak ankimi në arsyetimin se, nga interpretimi sistematik i neneve 59 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, i vetmi shkak për të cilin mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kontrollin e pasurisë, është *parashikimi në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 (kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë)*, në situatat kur Komisioni nuk gjen dëshmi pozitive për fshehje të pasurisë. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për fshehje të pasurisë si analizuar edhe në këtë vendim dhe, rrjedhimisht, sipas tij, nëse ai nuk ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, ai duhet të konsiderohet se ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e këtij kriteri, në kuptim të *parashikimit të nenit 59, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016*.
110. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se tashmë Kolegji ka krijuar jurisprudencë të konsoliduar, në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të *parashikimit të nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016*, në lidhje me raportin e pavarur që kanë këto dy dispozita në prodhimin e pasojës juridike të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duke e gjetur

pretendimin e subjektit se *i vetmi shkak për të cilin mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kontrollin e pasurisë, përveç rasteve kur gjen dëshmi pozitive për fshehje të pasurisë, është parashikimi në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të pabazuar në ligj. Ky qëndrim është tashmë i konfirmuar edhe nga vendimmarrjet e GjEDNj-së⁴⁷ lidhur me çështjet e rivlerësimit të gjykuara nga kjo gjykatë.*

111. Në këto kushte, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në vijim të konkluzioneve të mësipërme në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për pasojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 630, datë 03.03.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllari.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 23.07.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

⁴⁷ Shih vendimet e GjEDNj-së lidhur me çështjet Xhoxhaj kundër Shqipërisë, Sevdari kundër Shqipërisë etj.